www.dardania95.ch

# INFO DARDANIA

## Gazetë periodike:

Redaktuar dhe financuar nga Shoqëria Kulturore dhe Artistike „Dardania“ në Winterthur të Zvicrës


**Opinionet** — Opinioni, recensimi si dhe analiza të ndryshme për SH.K.A „Dardania“ në peridha të ndryshme, faqe 4 - 8

**Kronikat** — Kronika të aktiviteteve dhe ngjarjeve të rëndësishme, të shoqërisë nga 25 vjetori e këtej, faqe 9 -13

**Prezentimet** — Reportazhe, vizita abëreshëve dhe kronika nga periudha e 25 vjetorit e deri më tani , nga faqja 50 - 54

**Manifestimet** — Manifestime të ndryshme nga 25 vjetori i shoqërisë deri më sot, në faqet: 21 - 39 dhe 57 - 63

**Festivalet** — Festivalet kryesore dhe pjesëmarrja jonë në to, nga 25 vjetori deri më sot, faqe : 17- 34 dhe 55 - 66

**Opinionet e anëtarëve** — Opinione të fëmijëve dhe anëtarëve, nga periudha e 25 vjetorit e deri më sot, faqe: 45 - 49











# SH.K.A „DARDANIA“ NË FOLEN E VETË!



Secilën herë ne fillojmë me ec me hapin e parë dhe vazhdojm me hapin e dytë, të tretin, kurse tani jemi në hap. Kyeredaktori:

# INFO DARDANIA 2024









Editorial

# Shekulli i shqipëtarëve, ende i copëtuar!

Shqipëtarët edhe këtë vitë kanë shekullin e tyre dhe pikërisht më 28 Nëntor, ne festojmë ditën e pavarësisë së Shqipërisë, pa tokat etnike të saj, pa ndonjë konferencë, pa ndonjë qëndrim dhe kërkesë para bashkësië ndërkombëtare, që ajo të mbaj konferencë si në vitin 1878 dhe ti zh`bëj ato që atëbotë ju dhanë tokat tona fqinjëve dhe okupatorëve tanë.

Natyrisht se një gjë e tillë do të ishte rendi dhe nevoja e kahershëme e institucioneve tona të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Kosovës Lindore, Malit të Zi, Epirit me Çamëri, dhe kudo që janë shqipëtarët, edhe në Turqi, Bullgari, Rumani, Itali si dhe anembanë botës kah janë, e kah nuk janë.

Tani ka vetëm disa organizata jo qeveritare që përpiqen të senzibilizojnë opinionin, së pari ndër shqipëtare, e më pas edhe atë ndërkombëtar, por ato iniciativa shtypen nga vetë qeveritë tona aktuale që nuk lejonë përhapjen e tyre me preteksin se Europa na akuzon se po kërkojmë Shqipërinë e Madhe, por ne në fakt nuk po kërkojnë Shqipërinë e Madhe por Shqipërinë natyrale, ato pjesë që na i kanë marrë hiq më largë se para 112 vitesh, pikërisht kur edhe po festojmë 112 vjetorin e Shqipërishë së cungueme. Na mbante shpresa se 100 vjetori do të na gjejë në një shtet të përbashkuar shqipëtar, por se shojnë edhe 12 vite tjera këtë se ka pritë askush nga ne, andaj po presin shekullin tjetër!


INFO DARDANIA

GAZETË PERIODIKE
KËSHILLI REDAKTUES
STAFI I SH.K.A DARDANIA
KRYEREDAKTOR
Shefqet Cakolli
DIZAJNI
Albulena Kqiku

FOTOREPORTER
Muhamet Kqiku & Shefqet Cakolli



KONTAKTI:
DARDANIA
Oststrasse 33
8400 Winterthur
www.dardania95.ch
info@dardania95.ch
dardania94@hotmail.com
Tel: 079 672 41 82
Fax: 052 243 11 93



Revista është falasë!
Vetëm shpenzimet e shtypjes, në baza vullnetare!
Njëherit kërkojmë bashkëpunëtor dhe vullnetar në lëmin e gazetarisë në mërgatë.

Përshëndetja nga:

Këshilli Redaktues!

INFO DARDANIA



NDALOHET RREPSISHT,
PËRDORIMI I TEKSTEVE DHE FOTOVE PA AUTORIZIMIN E EDITORIALIT TË INFO DARDANIA



Prof. Dr. Rexhep Munishi, etnomuzikolog

# P A R A T H Ë N I E ( e librit Monografik të SH.K.A „DARDANIA“ )

## ( Punë e vlefshme dhe e dobishme për kulturen shqiptare)

### Si e njoha Shefqet Cakollin!

Kishte kohë që në forma të ndryshme kisha dëgjuar dhe isha i informuar për aktivitetet kulturore që po i zhvillonte një Shoqëri Kulturore-Artistike shqiptare në Winterthur të Zvicrës. Poashtu, isha informuar për themelimin e kësaj shoqërie dhe natyrisht edhe për emërtimin **“Dardania”**. Por takimin- kontaktin fizik me veprmtarët dhe anëtarët e kësaj shoqërie e pata në rrethana interesante. Sëpari po nisë rastin e takimit me veprimtarinë, udhëheqësin, koreografin dhe me një fjalë njeriun më meritor të ekzistimit të kësaj shoqërie Zotin Shefqet Cakolli.

Në festivalin e folklorit mbarëkombëtar të vitit 2009 që u mbajt në Gjirokastër unë isha anëtar i Jurisë profesionale, dhe që në provat e paraditës që mbaheshin në kalanë e Gjirokastres për mbrëmjen e parë të kësaj ngjarjeje të madhe rastësisht shoh një njeri që me kamerë të mirë bënte filmime edhe të përgatitjeve për nismën e festivalit. I afrohem me kujdesë, i prezentohem, ( me bënë të njohur se e din kush jamë) dhe pasi i shkëmbejmë njoftimet se kush jemi, unë drejtpërdrejtë i shfaq interesimin, deshirën qe pasi ti filmonte të gjitha mbrëmjet e festivalit po qe e mundur të mi sigurojë video-e audio incizimet e pesë mbërmjeve të festivalit .Pa hezituar, dhe pa u hamendur fare me premton se: “kjo punë ashtë e kryer”.




Pas këtij takim në Gjirokastër në mënyrën më spontane nisi të forcohej miqësia e jonë. Takimi më i fuqishëm e mbresëlënës ishte ai në festivalin folklorik “Hasi Jehon” i organizuar në Gjonaj më 4,5,6, maj 2012. Në mbrërmjen e tretë të këtij manifestimi prestigjioz me program të shkëlqyer u paraqit edhe Shoqëria

Kulturore shqiptare “Dardania” e ardhur nga Zvicra. Me programin e përgatitur, llojllojshmërinë, cilësinë e të gjitha pikave jo vetëm që mahniti publikun por thjesht e “detyroi”: Jurinë profesionale (kryetar i së cilës isha unë) pa hezitim ta shpallë shoqërinë më të mirë të festivalit dhe ta shpërblej me çmimin e parë të emërtuar nga organizatori “Malësori”.

Nuk jam i bindur se mund ti dilet haku këtij personaliteti veprimtaria e të cilit është aq e shtrirë, aq cilësore, sa që për ta paraqitur në tërësi i duhen disa shkrues me disa vëllime. Kontributi patriotik, kulturor është dëshmuar në veprime konkrete. Shefqeti ka dhënë pasqyrën më objektive dhe më afirmative për kulturën dhe për shqiptarët në përgjithësi. Tani, kur në ketë dhjetor të këtij viti (2014) po shenohet një jubile 20 vjeçar i aktivitetit të Shoqërisë "Dardania" është bërë rregull konvencional që me këtë rast të përgatitet në formë shkrimore një botim i veçantë për të cilin në vazhdim shfaqim mendimin tonë.



## Rrugëtimi monografik për "Dardania"

Tash pas premtimeve të mia të dhëna Shefqetit se do ta shkruaj Parathënien për Monografinë, më duhet ta mbajë fjalën që sëpaku të shfaq mendimin tim profesional për një publikim monografik kushtuar përvjetorit të 20 të themelimit të Shoqërisë Kulturore- Artisikte: "Dardania" në Winterthur të Zvicrës. Kisha një intutitë të fuqishme dhe një besim ndoshta pak të tepruar se botimi i përgatitur do të jetë në nivelin jo vetëm të deshiruar po edhe me standarde të një shkallë të lartë shkrimore, teknike, po edhe gjithëpërfshirëse të aktivitetit të kësaj shoqërie.
Marr dorëshkrimin në duar, e shfletoj disa herë, i shoh të dhënat, vështrojë mbashtrimin kronolgjik të temave të shtruara në libër, dhe bindëm në intuiten time të shfaqur parapraksht.

## Pak fjalë për përmbajtjen

Që në shikim të parë pa shfletuar asnjë faqe të dorëshkrimit vërehet qartë dora e një profesionisti të skalitur në punën e gazetarisë, informacionit, hulumtimit po edhe të një çasje intelektuale për ta prezentuar një punë 20 vjeçare të një shoqërie që ka kultivuar dhe vazhdon të kultivoj vlera etnokulturore shqiptare të trashëguara nga brezi në brez.
Libri ka një strukturë tipike monografike të shtruar me tema që përfshijnë jetën, aktivitetin dhe rezultatet kulturore të shoqërisë "Dardania" Botimi nis me një **Parathënie** autoriale që mund t'i ngjajë një recensioni për monografinë shkruar nga R. Munishi, pason **Hyrja** dhe më pas renditen temat e karakterit kronologjik. Hyrja është një letërnjoftim i shkurtër shkrimor për Shoqërinë Kulturo Artistike "Dardania" që tash e 20 vite vepron aktivisht në Winterthur të Zvicrës. Nga rreshtat e parë shkruesi shoqërinë e trajton si "fole e kultivimit dhe zhvillimit të kultures, traditës dhe ruajtjes tonë kombëtare në megrim". Janë disa nëntema të kësaj **Hyrjeje si: Synimi i "Dardanisë"-trashëgimi shekullore, Ruajtja e rinisë, gjuhës, traditës shqipe frymëzime kontinuele, Faktorët që linden "Dardaninë, Pormotorët artdashës** janë këto njoftime që rrumbullakësojnë **Hyrjen.** Konceptualisht shkruesi sikur qëllimshëm monografinë e ka vëndosur në tri çështje,tema qendrore përmes të cilave lexuesit i ofrohet mundësia ta njoh, ta shoh e ta përjetojë më afër. Kryetema është: **"Dardania" Nepër vite**. Këtu shkruhet për nismën, ecurinë-rrugëtimin e "Dardanisë", për moment të rëndësishme nga veprimtaria e saj dhe natyrisht për pasurinë etnokulturore të shfaqur gjatë këtij rrugëtimi.

Shkruhet për vallet, këngët, instrumentet etj.
**PROJEKTET E DARDANISË** është tema e dytë e radhës ku i intersuari njihet me projektet që Dardania ka realizur me shumë sukses për këto dy dekada. Dhe këtu shkruesi veçon ato projekte që i duken më të rendësishmet. Projektet janë të karakterit kulturor po edhe humanitar. Është projekti : "**Fata Morgana", 15 vjetori i shoqërisë** ( i kremtuar me shumë aktivitete kulturore-artistike), **Tingujt e Dardanisë** të vëndosur në CD dhe DVD incizime që kanë bërë jehon të madhe te shumë intelektual, gazetar etj. Për këto audio e audio-vizuelo-materiale janë bërë disa shkrime vlerësimesh mjaft afirmative, në veçanti shkrimi i Agron Bajramit. Në Projekte shkruesi i monografisë nuk lë anash as veprimtarinë humanitare të realizuar nga kjo shoqëri si: ndërtimi i shtëpive për të pastrehet, ndihma materiale për skamnorët, personat e sëmurë me nevojë për sherim e forma të tjera të ndihmave.

Opinione

**Na duket pak sa e pamjaftueshme hapësira shkrimore që i lihet pjesës apo veprimtarisë më të rendësishme që ka pasur kjo shoqëri. Fjala është tërë atyre paraqitjeve programore në festivale, koncertete ku është shfaqur ajo vlerë kulturore me të cilën shqiptarët krenohen dhe identifikohen. Nga këto shfaqje "Dardania" ka sjellur shumë mirënjohje, shperblime si dëshmi e një pune të pandalur që e kanë bërë të gjithë " dardanët" e kësaj shoqërie që në ditët e dhjetorit me mburrje kremton 20 vjetorin e themelimit.**

Një pjesë të mirë të tekstit u kushtohet mendimeve e impresioneve të marra nga programet e shfaqura nga Shoqëria "Dradania". Dhe kjo pjesë shkrimore mban titullin: OPINIONET. Paraqitjet publike me programin e shoqërisë "Dardania" janë të panumërta. Shfaqjet programore të kësaj shoqërie janë realizuar në koncerte, festivale e manifestime karakteresh të ndryshme. Dhe, të gjitha këto janë përcjellur me pritje mahnitëse nga publiku qoftë ai i huaj po edhe ai shqiptarë. Programi i larmishëm, me elemente të fuqishme autoktone shqiptare ka ngritur emocione të larta duke duke lënë mbresa fuqishme. Në këtë konteskt shumë nga të pranishmit kanë shfaur mendimet e tyre për impresionet që ka shkaktuar program I shfqjeve të caktuara. Dhe, autori i kësaj monografie me një sens prej shkruesi I ofron lexuesit mendime të marra nga personalitete profilesh të ndryshme; diplomatë, intelektualë, shkrimatarë, gazetarë, profesionistë (etnomuzikologë, etnolog, etnokoreologë etj.) nacionalitetesh të ndryshme: shqiptarë e jo shqiptarë. Mendimet e tyre të shfaqura nuk janë gjeste kurtoazie, por impresione të sinçerta dhe të ndjera thellësisht.
Sadoqë, nisiativa dhe kontributi me të drejtë i vishen Shefqet Cakollit, ai i vetëm nuk do të realizonte atë që ka arritur ta bëjë me këtë shoqëri pa ndihmen dhe kontributin edhe të të tjerëve. Prandaj, autori i monografisë ka kryer detyrimin e tij moral e profesional jo vetëm për t'u shprehur mirënjohje po edhe për tu kushtuar nga një shënim emrash të gjithë atyre që kanë dhënë mundin dhe shaqur dhuntinë e tyre në planin interpretues kullturor. E këta janë interpretët: këngëtarë, valltarë, instrumentistë dhe të gjithë anëtarët e tjerë që në çfarëdo mënyre kanë luajtur rolin e tyre në veprimtarinë e shoqërisë "Dardania".



Përkushtimi për këta individë është paraqitur në pjesën e fundit të librit që zë një hapësirë të mirë të këtij botimi.



Nuk është punë e lehtë që një veprimtari tepër aktive përgjatë 20 vjetëve ta vëndosësh në një monografi (libër) qoftë edhe me shumë faqe, në fund del se është e pamundur përfshirja e gjithë asaj djerëse, atij mundi, asaj pune, atyre përjetimeve, kënaqësive, që i ka ndjerë i tërë kompleksiteti "Dardania". Monografinë e ka përgatitur **Shefqet Cakolli**. Ziliqarët, mosbesuesit, intrigantët ( eventual), dhe të gjithë ata që provojnë të gjejnë mangësi të këtij botimi mund të flasin e flasin, por mund të veprojnë kështu vetëm nëse janë të prirë, prej zemërvogëlie eventuale të tyre nëse dyshojnë në objektivitetin e hartuesit dhe pse pikërisht Shefqet Cakolli, prijësi i kësaj shoqërie. Të gjithë këta do të kishin të drejtë sikur e gjithë ajo që shkruhet, thuhet në këto faqe libri nuk janë ashtu si i prezenton autori. Duhet ta kuptojmë objektivisht, njerëzisht, intelektualisht, se asnjë shkrues tjetër sado që mund ta "qëndiste" ndoshta më mirë, nuk do ta thoshte, shkruante atë që e ka përjetuar, atë trashëgimi kulturore shqiptare ka




arritur ta vëndos vetë Shefqeti në skenë dhe ta prezentoj para publikut të mjediseve shqiptare e jo shqiptare. Dhe, natyrisht nuk duhet pasur as më të voglin dyshim në nivelin intelaktual, shkrimor që Sh. Cakolli posedon. Prandaj, monografia që do të publikohet do të mbetet dokumenti më fisnik, më besnik, më autentik i prezentimeve të shumta përgjatë 20 viteve duke shpalosur vlera të trashëgimisë kulturore shqiptare.

dalin shprehjet më të fuqishme për ta madhështuar sa më shumë botimin e caktuar. Por, unë në rastin konkret sikur jam me fat që nuk do ta

mundoj mendjen time për t'i zgjedhur fjalet dhe fjalitë e mëdha pa pasur mbulesë profesinale. Pa asnjë masë kurtuazie dhe pa e lëkundur në asnjë moment etikën time profesionale e them se prezentimin e këtij botimi nuk e




Dhe kjo është për mburrje, përgëzim, si gadishmëri për mbështetje morale, profesionale po edhe materiale prej atyre që pritet se duhet ta bëjnë kudo që janë.

## Disa mendime përmbyllëse

Nuk jemi as të parët e as të fundit që shkruhet ndonjë parathënie për botime karakteresh nga më të ndryshmet. Dhe konvencionalisht këto shkrime nga arsye të ndryshme përshkohen me diskurse apologjike dhe nga shkruesit

pata aspak të vështirë ta bëjë, sepse puna, entuziazmi, angazhimi e mbi të gjitha vlerat e prezentuara në një botë jo shqiptare( mëse shpeshti) vërtetë kanë qen reprezentative, dëshmi e një kulture për ta lakmuar e një

kulture që me fuqinë më bindëse shpreh identitetin e terësisë kulturore kombëtare shqiptare.

Tash në këto kohëra mundësia e dokumentimit, prezentimit është pakufishme në forma audio, audiovizuele në mjetet e



Teksti i shkruar për aktivitete ilustrohet me shumë fotose, ku paraqiten formacione orkestrale, këngëtarë, instrumentistë, vallëtarë e vallëtare, pjesë nga lojëra e rituale popullore etj. Me një fjalë libri i shkruar për **“Dardaninë”** është i realizuar tekstualisht e teknikisht në nivelin e lartë të deshiruar.

Publikimi me rastin e këtij jubileu nuk ka karakter shkencor, është ky një dokument kulturor i një kohe në një hapësirë jasht ambientit autentik hapsinor e kulturor shqiptar. Monografia ofron të dhëna që studiuesit fushash të shumta studimore të etnologjisë, antropologjisë kulturore, etnmuzikologjisë, etnokoreologjisë, etnoorganologjisë etj.

komunikimit masiv e sidomos përmes internetit, dhe kjo vetëm sa është një lehtësim i shpejtë i propagimit. Por, pesha e vënies në letër së një veprimtarie tepër të sukseshme kulturore jashtë mjedisit shqiptar i kalon caqet e kategorisë kohë dhe hapësirë. Libri do të mbetet dokumentimi referues që mund t’i shërbejë cilitdo individ, grup shoqëror që shfaq interesimin për të marrë informacione për tërë atë që në shkencat humane quhet kulturë shpirtërore e materiale e një kombi.



Vetëm ai që e ka pasur në kokën e tij e di sa paraqitet e vështirë dhe e mundimshme shfaqja besnike e kultures së një vendi autentik në një mjedis tjetër kulturor qoftë edhe kur publiku mund të jetë i asaj përkatësie kulturore. Pikërisht kjo është për t’u admiruar se sa me sukses është arritur që SHKA “Dardania” në programin e saj të shfaq dukuri, fenomene, instrumente, lloje këndimesh, valle dhe natyrisht kostume nga më të larmishmet që ka kultura shqiptare. Në tërë këtë janë shënuar koncerte, shfaqje, festivale e paraqitje publike formash të ndryshme.

Publiku i disa mjediseve kanë pasur mundësinë për aq kohë sa kanë zgjatur shfaqjet koncertale të shohin e dëgjojnë vlera identifikuese të kultures materiale e shpirtërore shqiptare.
Publikimi përmes tekstit të shkruar i ofron lexuesit për rrugëtimin kulturor 20 vjeçar të shfaqur në forma të ndryshme paraqitjeje.

Shefqet Cakolli ka dëshmuar njohurit të bollshme të së kaluarës sonë kulturore. E themi kështu sepses humë nga llojet e të këdnuarit, valle tipike tradicionale, rite, lojëra popullore të vjetra, instrumente tipesh të ndryshme që tashmë kanë ikur nga jeta e përditshme e njeriut shqiptar. Shefqeti shumë nga këto ka arritur t’i kthej në skenë dhe të mahnitë spektatorin dhe të shkaktojë atraksione kulturore që dëshmojnë shtresime kotinuele të trashëgimisë së pasur tradicionale shqiptare.

---

Biografia e Shefqet Cakollit është jeta jo edhe aq e lehtë dhe veprimtaria e puna tejet rezultative. Shih në f.…
Shefqeti ka mbajtur fjalën dhe të gjitha materialet e filmuara gjatë tërë kohës sa ka zgjatur( 5 netë koncertale) festivali me vullnet të madh mi ka sjell në shtëpinë time në Prishtinë.
Dhe, me këtë rast shprehi falenderimin më të madh që këto filmime të gjendën në arkvin tim personal.
Gjatë takimit tone që në vitin e kaluar e dija se po përgatitej një Monografi për Shoqërinë “Dardania” nga Zvicra dhe unë i kisha premtuar se do ta shkruaj një Parathënie me rastin e botimit.

Prishtinë, 12.10.2014

# 25 VJETORI I SH.K.A "DARDANIA" SHËNOHET NË NËNTORIN E PËRLOTUR NGA TËRMETI NË SHQIPËRI!

***Mblidhen edhe mjete financiare nga shënimi i 25 vjetorit të saj, në vlerë prej 2760 Fr.- nga të pranishmit***




*25 vjetori dhe grupi i të rriturëve, me musfirët e ftuar, nga Shqipëria e Kosova!*

Edhe për kundër rrethanave të vështira të popullit tonë këto dita, SH.K.A "Dardania" nga Winterthuri kishte pregadit me kohë festën e 25 vjetorit të themelimit të saj, dhe festën e 28 Nëntorit, mandej festën e Pavarësisë së Shqipërisë dhe festën e Flamurit Kombëtarë.
Mirëpo lëkundjet sizmike që ranë më 26 Nëntor, në Durrës dhe Thumanë, preken thellë zemrat e popullit shqipëtarë në përgjithësi, sepse përpos dëmeve të konsiderueshme materiale, mori me vete edhe 51 viktima, dhe me këtë popullin tonë e kaploj një dhimbje për humbjen e njerëzve, edhe përkundër festave të Nëntorit që ishin në prag, ato u mbajtën shumë simbolike dhe krejt ndryshe nga herave tjera.
Po ashtu shumë nga manifestimet u anuluan anekënd botës shqipëtare, por pati edhe të tilla që festën e nëntorit e shëndrruan në solidaritet, sikur edhe vet SH.K.A "Dardania" që kishte organizu një kënd të veqant dhe kishhte shftytëzu kontoj e saj për grumbullimin e mjeteve financiare në formën elektronike, për ata që do të ndihmojnë drejt për drejt të prekurit nga tërmeti në Shqipëri, dhe me një  program artistik kushtuar momentit edhe pse kohë e shkurtër,  ato u modifikuan për momentin e fundit dhe dolen për tu solidarizua edhe me viktimat dhe me qëllimin e grumbullimit të ndihmave financiare për të prekurit.




*Plakata dhe kontoja e ndihmave humanitare për ndihmat në Shqipëri me rastin e tërmetit të vitit 2019!*

Shënimi i 25 vjetorit të SH.K.A “DARDANIA” këtë vikend që lame pas kishte një organizim të denjë sa i përket pregaditjeve, dekorimeve dhe sallës që ishte stërmbushur me të pranishëm dhe të ftuarit nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, dhe trojeve tona, por edhe nga mërgata që jeton dhe vepron në Winterthur me rrethinë. Me një film dokumentar filloj kështu shënimi i 25 vjetorit të themelimit të kësaj qendre kulturore e cila përshkrou në 10 minuta gjithë veprimëtarin e saj në periudha të ndryshme, qofshin edhe ato të luftës së fundit ku i është këndua heronjëve dhe të rënëve të UÇK-së e cila solli lirinë bashkë me miqët tanë.

Më pas stafi artistik kishte pregadit një monolog përcjell me një vjersh të pregaditur enkas për këto momente nga Albulena Kqiku – Cakolli, e cila përloti sallën me



interpretimin e saj dhe përcjellja e gjithë grupit të vallëzimit me 51 qirinjë të ndezur në shenjë respekti për viktimat e tërmetit, ku përcollën mesazhe dhembje për viktimat duke krijua një heshtje të thellë përcjellë me një muzikë në prapavij, e që përshkrou vërtet një qetësi të pa pare deri sa u krijua edhe një zemër e madhe në sken me 51 qirinjët, për të vazhdua më pas me hymnin kombëtarë, e më pas për ta hapur shënimin e 25 vjetorit po ashtu nga moderarorja Albulena Kqiku, me çka ftoj kryetarin e shoqërisë ti përshëndes të pranishmit dhe dhe ta hap shënimin e 25 vjetorit, ku ky i fundit, me një here kërkoj një minut heshtje për të gjitha viktimat e tërmetit të fundit, duke kërku po ashtu mirëkuptim për rastin dhe solidarizimin me aksionin që po pregaditej në një kënd të hollit të sallës, dhe në bynë me  nje baner të madhë për grumbullimin e mjeteve financiare, me një rezulltat që në fund rezultoj të grumbulloheshin  2760 fr.- për të prekurit në Shqipëri.

momenti dhe për ti këndua çamëve dhe masës së tubuar, me këngën e tyre përmalluese "Mallë për Çamërinë" dhe "Toka amë" kushtuar flamurit. Natyrishtë se kryetari Shefqet Cakolli nuk harroj ti përshëndes edhe bashkëpunëtorët dhe shoqëritë e ansamblet si motra në shënimin e këtij përvjetori dhe jubileu të 25 viteve veprimëtarie si; Shkolla Shqipëtare e Vallëzimit "Shota" në Zvicër, kësaj radhe pa mikun e ç`muar të kësaj shoqërije Agron Bajramin i cili vdiq vitin e kaluar, mandej ansamblin "Vatra" në Bülach, shoqata "Bashkimi" në Uster, ansambli " Arbëresha" në Sirnach, mandej Grupi "Rinia" në Schpreitenbach, shoqatën "Plisat" në Dübendorf, Shoqata "Sharri" nga Romanschorni, shoqatën "Atdheu" në Manchendorf, Unionin e klubeve sportive në Zvicër, dhe shumë e shumë të ftuar tjerë.
Më pas përkundër programit të modifikuar, kryetari foli disa fjalë për situatën dhe zhvillimet e dhimëshme në




Pas përshëndetjes së musafirëve si: Kryetarin e Komunës së Winterthurit z. Michael Künzle me bashkëshorten, përfaqësuesit e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike të Kosovës, drejtoreshën  Maliqe Hashani dhe dy përfaqësues tjerë të stafit të saj si Elis Badalli dhe Burbuqe Matoshi, e cila  ministri në fakt ishte edhe bashkëfinancuese e këtij shënimi të 25 vjetori, mandej përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës z. Sami Piraj, zyrtar i lart i kësaj ministrie, profesori i njohur i koreografisë në trojet tona z. Dilaver Kryeziu, mandej drejtori i SH.K.A " Malësori" në Gjonaj, njëherit asambleist në komunën e Prizerenit z. Haziz Hodaj, Gëzim Alimehmeti drejtori dhe përfaqësuesi i FIDAF-it për Shqipëri, dy bilbilat Çamë, Enkelejda Arifi dhe Hysni Alushi edhe pse në kushte të vështira kishin ardhur pavarësisht momentit, për të ju bashkua këtij

Shqipëri dhe apeloj që të ndihmohet sa ka mundësi popullata e prekur në tërmetin e fundit, për të ju urua 25 vjetorin e themelimit dhe 28 nëntorin në këto momente të dhimbëshme. Më pas moderatorja ftoj po ashtu edhe kryetarin e Komunës së Winterthurit z. Michael Künzle i cili foli fjalë të mira për këtë shoqëri, duke e konsiderua një urë lidhëse në mes komunitetit shqipëtar dhe atij zviceran, me çka po tregon dhe ka tregua se kjo shoqëri ka vërtet një mbështetje dhe respekt edhe nga ne, për kontributet që ka dhënë në integrimin e shoqërisë suaj në këto vite të një çerek shekulli.
Më pasë kuptohet nën modifikim të programit u këndua një këngë për Dardaninë nga okestra e saj dhe, dhe në shenjë të ndihmave të shtetit të Zvicrës po ashtu ishte pregadit një valle zvicerane enkas edhe për zviceranët që ishin prezent në sallë, për të vazhdua me vallen e zanave nga grupi i vajzave që në një form përcollen mesazhin se

zanat janë ato që ishin të shqetësuara me momentin që u krijua këto ditë dhe po mundoheshin të ngushllojn edhe përmes valleve të tilla skenike.
Natyrisht se grupi i fëmijëve performuan me grup vallesh korografike të cilët lanë mbresa të mëdha te publiku edhe për kundër momentin, ata ishin aq modest sa edhe vallëzimet i bënin me një respekt të veqant.
Më pas u ftuan të marrin fjalën musafirë dhe të ftuarit e 25 vjetorit si zonja Maliqe Hashani, drejtoresha e DRKAKD-së në emër të MDIS-it, përshëndeti të pranishmit dhe u dhuroj kryetarit të saj në emër të SH.K.A "Dardania" për këto 25 vite.
Natyrishtë se fjalën e mori edhe koreografi dhe proferori Dilaver Kryeziu, i cili bëri një paralele me vendin dhe mërgatën, ku tha se më mire po e ruani ju kulturën dhe traditën se sa disa në Kosovë, Shqipëri e trojet tona.
Edhe drejtori i SH.K.A "Malësori" nga Gjonaj, z. Haziz Hodaj foli për këtë shoqëri që po jep maksimumin e vet për ruajtjen e identitetit në këto rrethana, ku fëmijët po lindin dhe rriten në mërgatë, por që po ruajn vlerat e veta kombëtare fal njerzve si Shefqet Cakolli, me stafin e tij,



solidarizua me situatën duke i kuptua rrethanat dhe përuroj shoqërinë për punën 25 vjeqare që po bënë në ruajtjen e identitetit kombëtarë.
Më pas fjalën e mori pëfaqësuesi nga Ministria e kulturës së Kosovës, z. Sami Piraj, i cili ceku rolin e kësaj shoqëria në rujten e traditave kulturore në mërgatë, me çka kishte sjellë me vete edhe një mirënjohje nga Ministri për ruajtjen e trashigimisë kulturore në mërgatë, me çka ja andaj ai solli po ashtu një mirënjohje për ruajten e vlerave kulturore dhe librin monografik që kishin botua këtë vitë.
Programi vazhdoj po ashtu me një pike muzikore në flaut me interpretim të Ulpiana Miftarit dhe një pike tjetër në interpretim në piano të valles instrumentale të bareshës nga Dhurata Cakolli, të cilat u përcollën me vëmendje nga publiku, ani pse ishin për here të parë para publikut në këtë fushë dhe interpretim direkt para masës së gjërë, ato




Vallja zvicerane, luajtur nga të rinjët tanë!




moren duartrokitje të mëdha nga publiku i madhë dhe shumë i qet edhe pse ca nga ata ishin me fëmij të vegjël. Natyrisht se nuk mungoj as eposi ynë i talentuar i të riut nga malësia e Shkodrës, Kristian Zefi i cili interpretoj këngë me lahut, kushtuar momentit dhe histories sonë, të lavdishme ndër shekuj.

çame luajtur me kujdes nga anëtarët e shoqërisë me një paraqitje brilante, së bashku me veshjet enkas për pjesën çame të cilët janë komuniteti më i përvuajtur në peridha historike, me çka edhe kryetari Cakolli, u ngjitë në skenë për ti faleminderu dhe dhuru nga një medaljon, dhe premtu që herave tjera të festojmë në mënyrë normale, dhe kërkoj mirëkuptim nga masa për rastin e tërmetit në Shqipëri, dhe mos mundësia për të festu kësaj here.
Krejt në fund anëtarët kishin pregadit një befasi për kontributin e kryetarit tash e 25 vite, edhe pse ky i fundit ju shmang ndarjes së mirënjohjeve që kishte pregaditë me kohë, për të gjithë ata dhe ato që kontribuan me vite në këtë shoqëri, për ta shtyrë në një datë tjetër manifestim dhe ndarjen e mirënjohjeve me 25 vjetorin e saj.
Pavarësisht asaj moderatorja Albulena Kqiku, ftoj anëtaren e shoqërisë Enisa Hotin që kishte thur disa fjalë prekëse për kryetarin e tyre, me çka vëreheshin momente prekëse




Natyrisht se edhe poezia “Nëntori i thyer” kushtua ngjarjeve të fundit recituar nga motrat Ulpiana dhe Diana Miftari, të cilat tekstin ja u kishte pregaditë nëna e tyre Valbona Miftari e cila gjithënjë punon me këto vajza të mrekullueshme në recitime, dhe vegla instrumentale, por edhe në vallëzime tek Dardania.
Për fund të programit ishte paraparë pjesa më e ndieshme e populli tonë dhe një breng kaq e gjatë e një pjese të popullit tone si Çamëria e cila ka mbetë ende jashtë kufijve natyror të Shqipërisë etnike, e për këtë SH.K.A “Dardania” kishte pregadit me kohë edhe një valle çame, për të përndjekurit dhe popullin çamë, me çka në bashkëpunim të dy bilbilave çamë Enkelejda Arifi dhe Hysni Alushi, u bë një modifikim enkas situates edhe pse të shtërnguar nga momenti, ishte e pa shmangëshme të lihet jasht programit një këngë kushtuar flamurit dhe mallit për Çamërinë, për të përfunduar kështu me valle

tek kryetari deri sa po fliste ajo, në emër të anëtarëve të shoqërisë, me rastin e 25 vjetorit të saj. Ajo e konsideroj si një prind të të gjithë anëtarëve dhe një kultivues i vlerave kombëtare prej nga kishte mbjell vlera edhe tek këta të rinjë, duke i dhurua një kupë në shenjë përkushtimi të tij, dhe një shumë simbolike të një pushimi modest pas gjithë asaj pune të lodhëshme të këtyre ditëve. Nga të gjitha emocionet që u krijuan edhe në sallë, kryetari ftoj edhe gruan e tij për t`ja falë një tuf lulesh që ishin dedikua atij, dhe ku i fundit po i dhuronte bashkëshortes në shenjë respekt dhe ndihmen shumë vjeqare në realizimin e synimeve të tija në këtë qendër kulturore.
Ai mes të tjerash dha shenjë se gjenerata e re tani e tutje duhet ti marr në duar ato që deri më tani kishin arrit, për ta faleminderu gjithë stafin e tij ai uroj që rinia dhe vete Enisa me shumë të tjerë të vazhdojnë hapin e tij.

Albulena Kqiku dhe Shefqet Cakolli,

Prezentime

# SH.K.A „Dardania" e Winterthurit, festoj së bashku 30 vjetorin e LAPSH-it me një program Artistik nga grupi i të rriturëve!




Vikendin që lamë pas, sigurisht se shumë nga lexuesit keni patur rastin ta shijoni festën e qytetit të Cyrihut, e cila mbahet çdo tri vite, dhe pikërishtë kësaj here ju bashkangjit edhe SH.K.A „ DARDANIA" nga Winterthuri, e cila sivjet po i mbush 25 vite të veprimëtarisë së saj kulturore, duke u paraqitur kështu në shumë prezentime të tilla si të dielen e kaluar në Festivalin Ndërkombëtar të Valleve Popullore të të gjitha nacionaliteteve që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër,





duke përfshir këtu shumë kultura nga shtete e nacione të ndryshme përmes valles dhe lojrave popullore.

Edhe pse ka here ishin bërë pregaditjet për një paraqitje të tillë, në mesin e shumë ngjyrave kulturore, anëtarët e Shoqërisë Kulturore dhe Artistike Dardania ishin kujdesur që të paraqiten me një kolorit të përzgjedhur të të gjitha trevave tona shqipëtare me një mozaik vallesh, dhe me thuaja se të gjitha veshjet tona kombëtare të popullit shqipëtar.

Ashtu edhe filloj defilimi nga garderobat në Zürich deri te byna në Lindenhof, ku do duhet të dalin në sken, duke defilua me dy flamujt, njërin të Shqipërisë dhe tjetri i Kosovës, sepse edhe ashtu organizatori «Internationales Volkstanztreffen Zürich» i kishte ftua të përfaqësojnë Shqipërinë dhe Kosovën, por nuk mungoj as flamuri i vetë shoqërisë që bartnin anëtarët dhe vallëtarët që u ngjitën në skenë për paraqitjen e parë me mozaik vallesh, të prezentuara aq mirë nga moderatorja zvicerane, për historikun e shoqërisë dhe përshkrimin e valleve dhe veshjeve karakteristike dhe aq të dalluara nga të pranishmit dhe pjesëmarrësit e tjerë të festivalit.



Pas shumë duartrokitjeve të thuaja çdo pjese të valleve të shkëputura të mozaikut, publiku ishte shumë i interesuar që përcillnin me vëmendje lëvizjet dhe veshjen e bukur të traditës sonë kombëtare e cila zgjoj një kurreshtje dhe pasion edhe për ata që filmonin me kamera dhe telefona të dorës, gjatë tërë kohës sa zgjati pjesa e parë e paraqitjes, për ta mbullur kështu me një duartrokitje të gjatë në fund të



pjesë së parë.

Më pas, pas një pauze të gjatë prej një ore, deri sa u paraqiten grupe tjera, vallëtarët e shoqërisë në fjalë ishin pregadit edhe për pjesën e dytë, por tani me një veshje tjetër dhe valle koreografike me elemente të epikës dhe burrërisë sonë tradicionale me vallen Dardane, të grupit të të rriturëve, mandej me vallen e Tropojës me grupin e mesëm dhe në fund edhe vallen e Gollakut me grupin e të rriturëve, që vërehej se ishin edhe më shumë pjesëmarrës, dhe më shumë pasion vërenin kërcimet tradicionale me domethënje që edhe i lexonin vetë me duartrokitje pas ndonjë epilogu domethënës të karakterit të traditës dhe zakonit tonë kombëtarë shtjelluar përmes valles, për ta përfundua kështu me një valle të përbashkët me publikun që zgjoj një gëzim të madhe te publiku kur, koreografja Arbnore Cakolli i ftoj të pranishmit në skenë, e ku vërshuan masivisht, gjë që ishte e vogël byna për ti zënë të gjithë të interesuarit.

Në përfundim të prezentimit dhe atmosferës impozante me publikun edhe një here moderatorja dhe moderatori falimenderuan shoqërinë kulturore për atmosferën e shkëlqyer që ja dhanë publikut, që deri atëhere nuk kishte ndodhë më parë.

Më pas në Lindenhof rastisi të jenë edhe qifti Gashi nga Kosova, që kishte një veprimtari të vogël, me produkte të patates, nga gëzimi që po merrnim pjesë në këtë festival, ftoj të gjithë vallëtarët që të shërbehen me nga një ushqim falas nga prodhimet e tija të freskëta, për hirë të krenarisë kombëtare, si që tha vetë ai.

Nuk munguan as kontaktet me grupet tjera



si me kroatët, gjegjësisht dalmatët, që kishte shumë ngjashmëri me veshjet tona ilire, e që bashkëpunimin me ta e tha edhe vet kryetari, i cili ishte shumë i kënaqur me pjesëmarrjen në këtë festival ku pati edhe disa takime me boshnjakët dhe arbëreshët e Italisë që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër.
E tëra kjo la përshtypje edhe nga prindërit që ishin pranë vallëtarëve të tyre dhe treguan se kultura është ajo që na bashkon ma së shumti, ku premtuan se do vazhdojnë edhe më tutje ndihmën e duhur për ta mbështetur këtë shoqëri deri sa të ketë mundësi.

Edhe gazetari i mërgatës sonë Rexhep Rifati, si gjithënjë nuk ngurroj të bëjë foto dhe shkruaj disa fjalë për aktivitetin e kësaj shoqërije, me çka ka një bashkëpunim të mirë thuaja se me të gjitha shoqëritë.

Kështu përfundoj edhe ky eviniment për të vazhu në paraqitjet e radhës, e në fokus të veqant ka sidomos 25 vjetorin që do të mbahet më 30 Nëntor 2019, në Winterthur të Zvicrës, ku janë të ftuar figura të politikës, kulturës dhe diplomacisë sonë në Zvicër.





# "Dardania", 30 vjet në shërbim të kulturës shqiptare dhe integrimit!

# SH.K.A „DARDANIA" e Winterthurit, e përfaqësonë denjësisht kulturën shqiptare edhe në Rüti të Zürichut!

Autori: Shefqet Cakolli

***Festa e qytetit të Rütit, gjallëroj me valle e kostume kombëtare të shqipëtarëve,***

Në festën „Festivali i fshatit të poshtëm" të qytetit të Rytit në Kantonin e Cyrihut, e nënë organizimin e shkollave të qytetit, ku merrnin pjesë shumë fëmij dhe prindër të shkollave të ndryshme, e që kësaj radhe u paraqitu edhe shqiptarët, nën përkujdesje dhe bashkëorganizim të zonjë Hydajete Ademi aktiviste dhe nën prezantimin e traditës dhe programit artistik të SH.K.A-së „Dardania" nga Winterthuri.

Me një program prej 30 minutash, i cili ishte një befasi e madhe për gjithë të organizatorët dhe drejtorinë e shkollave të qytetit, por edhe një risi për të pranishmit me paraqitjen e larmishme me valle koreografike luajtur nga dy grupet artistike dhe krejt në fund valle të përbashkëta me surle e tupanë.

Por, respektimi i kohës la shumë të pranishëm me dëshirën që të vazhdohet edhe më tej ritmi i valles dhe vallja e përbashkët me publikun.
Ashtu siç ishte paraparë, nga ora 13:30 anëtarët e SHKA „Dardania" u ngjiten në skenë për t'iu treguar të pranishmëve se çka kishin përgatitur gjatë interpretimit të programit të tyre, ndërsa për neve në publik nuk mungonin fjalë miradije dhe komplimente nga vetë



zviceranët për veshjen , vallet dhe veglat muzikore, sidomos të atyre me frymë, si surla dhe daullja.

„Mua po me fascinon ky vullnet dhe kjo paraqitje kaq e bukur e shqiptarëve dhe e kësaj shoqërie me gjithë këta fëmijë, të rritur dhe të moshuar. Pra këtu janë të gjitha gjeneratat dhe diçka të tillë ende nuk kamë parë", ishte komenti i një shikuesi, të cilit nga zhurma e muzikës dhe e valles nuk arritëm t'ia mbajmë në mend emrin. Për SH.K.A „Dardania" nga Winterthuri, me pak fjalë foli edhe vallëtarja e kësaj shoqërije Besiana Mazreku, e cila prezentoj pikat dhe një histori të shkurtët të kësaj qendre, ku më pas filluan paraqitje e grupit të vegjëlve, me vallen e Lokut dhe një mozaik vallesh, për të vazhdua me grupin e të rriturëve me vallen e Gollakut dhe vallen Tiranase,



për të përfundu kështu me grupin e orkestrës udhëhequr nga Hamit Shillova dhe Mehmet Sermaxhaj me surla, dhe Tefik Shavda me tupanë, prej nga u kyqen të gjithë vallëtarët në kostume si dhe publiku që festonin së bashku në valle rrethë e rrotullë, gjithë së bashku.



Gjatë paraqitjes së kësaj shoqërie, që tani më i ka kalua 28 vite të veprimtarisë, pati shumë duartrokitje dhe bashkëvallëzim nga masa e tubuar në gjysmëhark, edhe pse vallet luheshin poshtë skenës.





*Një valle koreografike me një pjesë të grupit të të rriturëve,*

Të kënaqur janë ndarë edhe kryesia e shkollave si dhe vetë drejtori i cili dhuroj nga një pije për secilin pjesëmarrës të shoqërisë, në mesin e 30 vetave sa ishin kësaj here, edhe pse në një bynë jo të mjaftueshme, ata fascionoheshin sidomos zonja Hydajete Ademi, e cila gjatë tërë kohës ishte aktive dhe lëvizëte për mbarëvajtjen e paraqitjes sonë, ku në fund shprehu se ishte tejet e kënaqur me paraqitje tonë, duke thënë se: „Na kemi z`drit ftyren kësaj here".

Edhe Shpëtimi nga Durrësi i Shqipërisë, cili banon në këto anë, dhe i cili kishte ardhur ta përcjellë nga afër këtë paraqitje, ka falënderuar udhëheqësin e këtij ansambli dhe shumë valltarë të „Dardanisë" që mundësuan të prezantohen edhe shqiptarët në këtë festë të qytetit, dhe organizuar nga shkollat e saja.

Për mbarëvajtjen e kësaj feste folën edhe vetë protagonistët e shoqërisë „Dardania", si Hamit Shillova, Mehmet Sermaxhaj, Tefik Shavda, e disa nga vallëtarët që ishin edhe për herë të parë në skenë, prej nga baca Hamit na tha se më paska marrë malli me pa valle dhe vallëtarë në sken, pas kaq vitesh pandemie dhe pengesash në paraqitjet tona. „Paraqitja jonë në mesin e kaq shumë pjesëmarrësish të tjerë, na jep vullnet dhe na inkurajon që edhe më tutje të vazhdojmë, me këto prezantime si kjo në Rüti", tha Hamit Shillova, një veteran i SHKA „Dardanisë". Ai është mjeshtër i veglave me frymë, mandej çiftelisë, këngës dhe gajdes, e në veçanti melosit të surles, pikë kjo skenike që zgjoi interesim të madhë te publiku.



Mehmet Sermaxhaj, po ashtu anëtar veteran i shoqërisë "Dardania" nga Winterthuri, ka kërkuar edhe më tutje të përkrahen nga prindërit si deri më tani, sepse sipas tij, pa ndihmën e tyre nuk do të mund të arrinim këto suksese.

Sadik Azemi, një prind, i cili ishte i angazhuar në organizimin e udhëtimit të anëtarëve të shoqërisë mes tjerash ka falënderuar udhëheqjen e shoqërisë dhe ka inkurajuar edhe anëtarët dhe stafin e shoqërisë për organizimin dhe programin e larmishëm, të cilën u paraqitën kësaj here, e në veçanti përmendi komentet pozitive të zviceranëve.

Tefik Shavda, një instrumentist i dalluar i SH.K.A „Dardania", ka porositur që të punojnë edhe më tutje, për të qenë edhe më të mirë në të ardhmen.

E gjithë koreografia dhe përzgjedhja ishte bërë nga Këshilli artistik, i përbërë nga kryesia e saj, dhe Arbnore Cakolli për vallet dhe Hamit Shillova, për orkestrimet, prej nga kishin përzgjedhur një program të larmishëm duke prezantuar edhe veshjet kombëtare nga të gjitha trojet shqiptare.

**Teksti dhe fotot: Shefqet Cakolli**

# “Dardania” përfaqësuese e mirëfilltë e kulturës shqiptare në Zvicër

Rexhep Rifati10/04/2021



**SH.K.A. “Dardania” nga Winterthuri, për më se çerek shekulli është një nga trupat e shquara artistike që përmes këngëve, valleve kostumeve e sidomos instrumenteve tradicionale prezanton në shtetin helvetik artin popullor shqiptar, madje jo vetëm këtu por edhe në manifestimet dhe festivalet prestigjioze, siç janë ai Folklorik në Gjirokastër, Festivali Ndërkombëtar në Cyrih, atë të folklorit në Lozanë apo edhe në Festivalin “Hasi Jehon 2012”, në Gjonaj të Hasit, ku edhe zuri vendin e parë.**

**Teksti dhe fotot Rexhep Rifati**

Ka kaluar më tepër se çerek shekulli qysh se SHKA “Dardania” nga qyteti i Winterthurit në kantonin e Cyrihut në Zvicër, që zhvillon një aktivitet intensiv kulturor duke kultivuar e avancuar artin popullor shqiptarë në Zvicër e më gjer.

**Takimi i parë me artistët e “Dardanisë”**

Ishte shkurti i vitit 2004, kur për herë të parë takova këtë shoqëri artistike në një program të përbashkët shqiptaro-zviceran që mbahej në qytetin e Usterit me organizimin e projektit “Urat” në kuadër Caritasit të Cyrihut. Në këtë takim, Shoqëria Kulturo-Artistike “Dardania” e Winterthurit me programin që shfaqi joshi me të madhe publikun vendas, sidomos me instrumentet karakteristike folklorike shqiptare. Atëbotë nga udhëheqësi i valleve, Hysen Abazi, mësuam se „Dardania“ kishte shkelur në 8 -vjetorin e themelimit dhe se në gjirin e saj tubonte më se 35 anëtarë , ndërsa që grupin e veteranëve e përbënin instrumentistët dhe këngëtarët: Hamit Shillova, Sefedin Ramadani, Bashkim Fekaj, Nezir Hyseni dhe Hysen Abazi. Ndërsa grupin e valltarëve : Liridona Abazi, Ardian Hyseni, Violeta Abazi. Denis Abazi, Gazmend Haliti etj. Derisa Hysen Abazi e udhëheq grupin e valleve, Bashkim Fekaj i prin grupit të këngëtarëve. Ndërsa, kryetari e shoqërisë, Shefqet Cakolli, që ka dhënë e po jep shumë për këtë shoqëri, si brengë ka indiferencën e subjekteve shqiptare, ndërsa që ngjet e kundërta me disa subjekte zvicerane. Kjo u vërejt edhe në fund të këtij programi, kur pjesëmarrësit në sallë, kryesisht vendas iu bashkuan valleve shqiptare të “Dardanisë”.

Nga ai koncert kaluan edhe 8-9 vite të tjera dhe veteranët e po kësaj shoqërie, ende nuk e kanë humbur energjinë, sepse masa duket ata pos pasionit për artin e mirëfilltë muzikor, i udhëheqë edhe një kolegjialitet që mbretëron brenda shoqërisë thuaja se nga ditët e para të themelimit. Atë ditë e sot përmes “Dardanisë” kanë kaluar edhe shumë e shumë valltarë, shumë nga të cilët edhe e kanë pasur të vështirë të shkëputen prej shoqërisë, ngase kanë filluar ta ndjejnë si pjesë të familjes së tyre.

Madje shumë nga veteranët këtë dashuri për këngën e vallen shqipe e nguliten edhe në mesin e fëmijëve të tyre, për të qenë edhe ata sot aktiv në gjirin e saj. Ndaj edhe me vite grupi i fëmijëve të kësaj shoqërie impresionon jo vetëm me lojëra tërheqëse popullore, por edhe me elegancë në skenë.

**Përherë vertikale me forcat e veta**

“Dardania”, duke u mbështetur vetëm në forcat e saj, po ndihma e donacione, por vetëm me kontributin e anëtarëve prindërve arriti që të pajiset jo vetëm me instrumente por edhe me kostume tejet karakteristike e tërheqëse të trevave të ndryshme shqiptare. Madje edhe për qepjen e disa llojeve të veshjeve u kujdesën vetë gratë shqiptare të këtij mjedisi në baza vullnetare. Programi i kësaj shoqërie kulmoi sidomos në 15 vjetorin e themelimit, por nuk u ndërpre aktiviteti as sot e gjithë ditën, madje edhe me koncerte humanitare për ngritjen e shtëpive për skamnor në Kosovë, apo në 25 vjetorin e themelimit të shoqërisë, kur u mbledh një shumë ndihmash për familjet që pësuan në tërmetin katastrofal në Durrës. Duke qenë pjesëmarrëse e manifestimeve të shumta “Dardania” u bë e njohur edhe në trevat shqiptare, sidomos me pjesëmarrjen e grupeve të tjera në Festivalin Folklorik në Gjirokastër në vitin 12015, ku veteranët e kësaj shoqërie tërhoqën interesimin e publikut të shumtë artdashës, duke e e veçuar pjesëmarrjen e gajdes si instrument të lasht shqiptarë.

**Por ti kthehemi Zvicrës , ku edhe “Dardania” vepron si shoqëri shumë aktive e cilësore, me një numër të madh anëtarësh.**

**Qindra artdashës zviceranë i duartrokasin “Dardanisë”**

Ishte 7 Korriku i vitit 2019, kur në mesin e dhjetëra grupeve artistike të komuniteteve të ndryshme në pjesën e vjetër të qytetit të Cyrihut, Sh.K.A. “Dardania” nga Winterthuri, shkëlqeu me interpretimin valleve të bukura shqipe, madje me dy prezantime brenda ditës. Gjatë tërë pikave të programit pjesëmarrësit e shumtë duartrokitën artistët tanë të veshur me kostume të bukura të trevave të ndryshe shqiptare. Loja e bukur dhe koloriti i kostumeve, bashkë me muzikën bënë që “Dardania” të shikohet e vlerësohet si njëra ndër grupet më të mira në këtë ngjarje kulturore, ku edhe njëherë qyteti i Cyrihut tregoi se sa çmohen kulturat e çdo nacionaliteti. Me atë rast Kryetari i SH.K.A. “Dardania”, Shefqet Cakolli, që prej themelimit me një angazhim të paparë mban timonin e kësaj trupe u shpreh shumë i kënaqur me pjesëmarrjen e grupit të tij, por përkujtoi se për shkak të hapësirës së kufizuar në skenë, nuk mundi ti sjellë më tepër sesa gjysmën e anëtareve të trupës së tij artistike. Do theksuar se “Dardania” hynë në radhën e trupave më të vjetra artistike shqiptare në Zvicër dhe se deri më tash ka marrë pjesë në disa festivale me karakter rajonal, kombëtar e ndërkombëtar dhe ku do është tregua e suksesshme dhe është prit mirë jo vetëm nga publiku shqiptar, si ndodhi edhe sot kur mori shumë duartrokitje nga qindra pjesëmarrës në këtë festivalin tashmë tradicional në këtë metropol të Zvicrës.

**Programe që përherë tërheqin interesim e publik**

Ja edhe ca rreshta nga manifestimi i mbajtur më1 Dhjetor 2018, kushtuar Festës së Flamurit Kombëtar, meqë rast në praninë e qindra mërgimtarëve, në emër të nikoqirit, përshëndeti kryetari Shoqërisë Kulturore dhe Artistike “DARDANIA” Shefqet Cakolli, që i bëri një vështrim aktivitetit të shoqërisë të cilën e drejton prej vitesh dhe u shprehi falënderime të gjithë atyre që e mbështetën mbarëvajtjen e kësaj trupe, që ka formësuar fizionominë e saj. Ndaj edhe ky program lirisht mund të thuhet se ishte ndër më të organizuarit dhe ndër më madhështorët, se ndonjëherë më parë.

Karakteristike për “Dardaninë” e Zvicrës është se ajo krahas veteranëve i kushton jo vetëm rëndësi por edhe hapësirë më të vegjëlve, çka u pa edhe gjatë këtij programi në Winterthur, kur fëmijët mahnitën sidomos me vallen e “Barinjve”.

**Burim kuadrosh edhe për ansamble të reja**

Karakteristikë tjetër e “Dardanisë” është se ajo ka qenë burim kuadrosh edhe për disa ansamble të tjera të porsaformuara, pra një familje e madhe prej nga burojnë artistë e grupe, në mënyrë që kështu edhe më tepër të pasurohet skena kulturore shqiptare në Zvicër dhe në mërgatë përgjithësish. Në këtë shkrim prezantues është e pamundur të përmendim gjithë atë aktivitet që ka zhvilluar “Dardania” deri më tash apo edhe ti përmendim atë mori njerëzish që dhanë kontribut të madh ndër vite , qoftë si artist, organizatorë apo edhe drejtues të kësaj shoqërie qetash më ka bërë emër si në mërgatë ashtu edhe në trojet shqiptare. Na mbetet ti urojmë suksese të më tejshme , përkundër situatës që ka rëndua dhe penguar punën normale të të gjitha grupeve dhe ansambleve shqiptare në Zvicër e më gjer. Për të gjithë ata që duan të dinë më shumë për këtë shoqëri artistike, mund të pajisën me monografinë kushtuar “Dardanisë”, një publikim tejet i kompletuar e cilësor, ku bëhet fjalë për rrugëtimin çerek shekullor të të kësaj trupe që tash më ka një fizionomi si në përmbajtje ashtu edhe në masivitet.

SH.K.A.DARDANIA

# Agron Bajrami, përkujtohet si ikon e kulturës shqipëtare në diasporë




Në fundjavën që shkoj, në Neuenhof të Argaut u organizua përkujtimi i parë i Agron Bajramit, në një vjetorin e vdekjes së tij, i cili la pas vetes një gjurmë të pa shlyer në punën dhe veprën e tij në mërgatë, e sidomos në Zcivër.

Përvjetorin e kishin organizu Shkolla Shqiptare e Vallëzimit "Shota" në Zvicër prej edhe nga dha kontributin, i ndjeri Agron Bajrami me vite të tëra.

Në këtë përvjetor dhe përkujtim të jetës dhe veprës së tij, kishin ardhur shumë shokë e miq, dashamirë të kulturës dhe të vet Agronit, nxënësit e Shkollës Shqipëtare të Vallëzimit „Shota", të gjeneratave të ndryshme, por kryesisht ata që edhe ishin pregadit për një program artistik të dy valleve që aq shumë i deshi dhe njëherit edhe i bëri koreografit e valles së demostratave që u prezentua në fillim të programit dhe vallen e UÇK-ës, që u luajt në fund të programit, e që kishte qenë edhe vetë pjesëtar i saj. Me një dokumetar të pregaditur nga Lesh Nikolla, që pasqyronte Agronin në universin dhe ujet e tij, për të komuniku sa do pak me familjarët dhe publikun, e që në fakt ishte një punë dhe ide e qëlluar për momentin dhe rastin e përkujtimit të parë të tij.
Më pastaj konferensierja hapi tubimin duke i përshëndet të pranishmit dhe duke ju kërku një minut heshtje të pranishmëve për nder dhe respekt për te.
Kështu edhe filloj programi i parapar me një nderim për jetën dhe krijimtarinë e Agron Bajramit, i cili i la shumë ëndrra dhe projekte pa i realizu, sepse sëmundja e mori para kohe.

Përpos koreografisë, që ishte edhe synimi kryesor i tij, Agron Bajrami, dha kontribut edhe në fusha tjera si në angazhimin e tij në sferën e politikës në mërgatë, e në veqanti angazhimi i tij në vijat e fronit të luftës së fundit të kombit tonë, prej nga u prezentuan edhe disa foto të tij në vija të frontit deri sa anëtarët e Shkollës Shqipëtare e Vallëzimit „Shota", deri sa vallëzohej vallja e UÇK-ës.

Nga një numër i madh i të pranishëmëve dhe ata që nuk kishin mundur të vijnë në këtë përvjetor, evokuan kujtime dhe momente nga më të ndryshme, duke fillua nga veprimtari, publicisti e shkrimëtari Ibish Neziri i cili përmblodhi një biografi të gjatë historike për punën dhe








lëvizjet e Agron Bajramit në periudha të ndryshme të aktivitetit dhe kontributit të tij në mërgatë e gjetiu.

Edhe zviceranja Regula Bachmann, e cila ishte njohur me Agron Bajramin në vitet e nëntëdhjeta, evokoj kujtime edhe familjare, edhe organizative e sidomos ato të veshjeve dhe traditave tona kombëtare që ajo nuk i kishte kuptua sa duhet, derisa Agroni ja kishte spjegua të gjitha.

Po ashtu edhe Sherif Dakaj, nga grupi „Rinia“, që ishte rrit dhe kishte qenë thuaja si familje e Agron Bajramit, evokoj

Mandej filluan radhazi të shpalosnin kujtime të ndryshme për bashkëpunimin dhe afrin miqësore që kishin patur me Agronin si; Fatmir Salihu poet e njohës i mirë i Agron Bajramit, mandej poeti dhe artisti Gani Bytyqi, i cili thuri ca vargje poetike në stilin e tij të poetit, në kujtim të jetës dhe veprës së Agron Bajramit.
Konferensierja Sara Bajrami, ftoj në radhe edhe bashkëpunëtorin dhe bashkë veprimëtarin e të njejtës lami, kryetarin e SH.K.A „Dardania“, i cili me emocione, elaboroj ca kujtime të veqanta për te duke i thur edhe një thënje nga emrat e familjes së tij: „Agroni e deshi aq shumë lirin, dhe nga shkëndijat e saja, shqipja valon sot me flamur“, kështu e përfundoj miku dhe bashkëpunërori i tij i dekadave të fundit, Shefqet Cakolli, kujtimin për Agron Bajramin.




Mendej edhe Osman Osmani veprimëtar i Unis-së në Zvicër, përkujtoj qastet e fëmijërisë që nga Prishtina, e deri në këtu në Zvicër duke e bart si udhërrëfyes i shumë shoqërive që u krijuan në Zvicër.
Rexhep Rifati, gazetar, njohësi më i mirë dhe më i dallua i të gjitha aktiviteteve në mërgatë, e në veqanti të Shkollës Shqipëtare të Vallëzimit „Shota“, që ndërlidhet edhe me vet Agron Bajramin, ai i potencoj sidomos brezat e rinj e në veqanti Artin nipin e Agron Bajramit, i cili u nda i fundit nga vendi ku ishte varrosur i ndjeri Agron Bajrami.

kujtime gati me emocione, me cka u betua për të vazhdu rrugën e tij.
Edhe Fatmire Kajtazi, vallatare në Ansamblin „Shota“ në Kosovë, si kolege dhe njohëse e afërt me Agron Bajramin shpalosi kujtime të veqanta sidomos, të viteve të 80-ta, kur Agroni ishte vallëtar në Ansamblin „Shota“ në Kosovë, me çka e kishin si ma të voglin në Ansambel.

Në radhë u ftua Mustaf Xhemajli, ministër këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Bernë, njëherësh dhëndërr i të ndjerit, i cili bëri një përshkrim të detajuar të njohjeve të tij me Agronin sa ishte 14 vjeq, e deri më sot, ku përshkrou nganjëhere edhe momente të „përplasjeve“ për ca qëshjte organizative e besa edhe pushtetare, krejt kjo në të mirë të mbarëvajtjes së aktiviteteve të mërgatës dhe formave të lëvizjes kombëtare.
Në emër të prindërëve të pranishmëve ju drejtua zonja Krasniqi, e cila falenderoj për gjithë çka kishte bërë dhe lënë pas veti Agron Bajrami.
Natyrishtë se në pamundësi për të qenë të pranishëm të gjithë në këtë përvjetor, me letra përshëndetëse janë drejtuar artistë e studiues të ndryshëm, miq dhe njohës të Agron Bajramit nga Kosova, Zvicra dhe nga Shqipëria, si: Artisti Llesh Nikolla, studiuesi i folklorit Zymber Neziri, ish drejtuesi i Misionit Katolik Shqiptar në Aarau, Don Mikel Sopi, koreografi Haki Mulliqi dhe kineasti Milazim Salihu.
Krejt në fund të pranishmëve ju drejtua edhe Lirije Bajrami tani më drejtoresh e Shkollës Shqipëtare të Vallëzimit „Shota“, e cila falenderoj të pranishmit, dhe premtoj se do vazhdoj edhe më tutje rrugën dhe punën që kishin nisë bashkë me Agronin, duke kuptua se në një të ardhëme të afërt, do duhej të quhej kjo shkollë e







vallëzimit, „Shkolla Shqipëtare e Agron Bajramit“.

Më pasë vajza e Agron Bajramit, Shqipja këndoj këngë e saj të preferuar për babain e saj, mandej edhe Alim Dauti këndoj këngën, „Te rrapi në mashkullore“, këngë e preferuar e të ndjerit Agron, për të vijua edhe nga dy të rinjë nga SH.SH.V „ Shota“ që kënduan një këngë për mërgimin.
Nuk munguan as vjershat për Agron Bajramin, recituar nga fëmijët e shkollës shqipëtare të vallëzimit „Shota“.
Ashtu si kanë një bashkëpunim të shkëlqyer dy si motrat: Shkolla Shqiptaree vallëzimit “Shota” si dhe SH.K.A “Dardania” e Winterthurit, ato kishin kordinu programin dhe këta të fundit, gjegjësisht grupi i rapsodëve, kënduan një këngë kushtuar pikërisht Agron Bajrami, e cila ishte shkrua dhe komponua enkas për këtë here, në shej respekti dhe bashkëpunimi që kishin patur dhe kanë me vite.
Edhe Isuf Rashiti, një kultivues i folklorit në mërgatë, kishte pegadit një këngë po ashtu eknas për Agron Bajramin,i cili u prit me duardtrokitje.
Emocione të veqanta zgjoi vajza e Agron Bajramit, Shqipja e cila kishte grumbullua disa kujtime të përditëshmërisë së saj, që nga fëmijëria, të cilat përcilleshin në prapavij pas këngës në gjuhën angleze, “Hurt”, enkas për babain e saj.
Krejt në fund ashtu si e cekem në fillim u ekzekutua vallja e UÇK-ës, me çka edhe u përmbyll kështu tubimi i përkujtimit të një vjetorit të vdekje së Agron Bajramit.

Autor: Shefqet Cakolli




# MËRGATA VLERËSOHET NË FESTIVALIN VITRUAL "ANADRINI FOLK 2020", "DARDANIA" ÇMIMIN E PARË

***Në fund të qershorit nga 20-25 qershor, u organizua festivali i parë virtual kombëtar i floklorit, krejt duke marrë për bazë pandeminë që ka kaplua thuaja se tërë botën, andaj kjo ide dhe ky organizim lindi nga SH. K. A "ANADRINI", me emërtimin "ANADRINI FOLK 2020" në Rahovecë.***




Me të marrë ftesën nga organizatorët, SH.K.A "Dardania" nga Winterthuri, ishte mobilize, edeh pse nën kushtet e pandemisë, ajo kishte pëlqye iden dhe me miratimin e kryesisë kishin vendos të merrnin pjesë me disa pika të filmuara me prezentime, ku pasqyrohen disa nga traditat tona të lashta, bartur edhe këtu në diasporë.
Si bartëse e shumë aktiviteteve dhe pjesëmarrëse të disa festivaleve, bile edhe ate të Gjirokastës, që në një farë mënyre është edhe kulmi i festivaleve tona kombëtare, kryesia dhe stafi i saj tash e 25 vite kanë çka të tregojnë për punën dhe sukseset e tyre. Andaj pa hezitim vendosën të marrin pjesë edhe në këtë form dhe momente të rënda për të gjithë nga pandemia Covid 19 më tash e njohur për të gjithë.
Pasi ishin grumbullua materialet filmike të mbi tridhjet sosh të shoqërive, ansambleve, grupeve të ndryshme
in Spahija, Sami Piraj, Jeton Pustina, Zymer Neziri, Shefki Salihu, Bebi Dobi, Vahit Kuçaj dhe Baki Xhaferi, dhe përcaktuan fituesit e edicioni të parë të këtij lloji.

Dhe po japim të gjitha çmimete ndara sipas kritereve dhe kushteve e prezentimeve të pjesëmarrësëve të këtij festivali, duke i marr të dhënat pikërisht nga drejtori i këtij festivali z. Xhefer Bytyqi i cili senzibilozoj dhe aktualizoj kulturën dhe traditën thuaj se të mbyllur tash e katër muaj.

*https://www.instagram.com/sh.k.a_dardania/*

1. Çmimin; Koreografia më e mirë. E fiton; SHKA “Rapsha” – Drume, Tuz, Malësi,
2. Çmimin; Dyshja më e mirë e valltarëve. E fiton; Dyshja e vajzave e Ansamblit folklorik “Selman Kadrija” - Istog.
3. Çmimin; Loja më e mirë popullore. E fiton; “Këngë bjeshke e vajzave” - Ansambli i Këngëve dhe valleve “Deçani” – Deçan.
4. Çmimin; “Rexhep Çeliku” (për valltarin më të mirë të festivalit) . E fiton; Ilir Loku, Ansambli “Ilirida” - Shkup.
5. Çmimi; “Afërdita Tupeci” (për valltaren më të mirë të festivalit). E fiton; Blerina Zekaj, Ansambli “Selman Kadrija” - Istog
6. Çmimin; Kostumet më të kompletuara tradicionale. E fiton; SHKA “Rapsha” – Drume, Tuz, Malësi e Madhe – Mali i Zi.
7. Çmimi “Leze Qena” (për paraqitjen më të mirë artistike) . E fiton; Ansambli “Selman Kadrija” - Istog.
8. Videoja më promovuese. E fiton; Ilir Loku, Ansambli “Ilirida” - Shkup.
9. Çmimi; “Sali e Feriz Krasniqi” (për grupin më të mirë të rapsodëve). E fiton; “Besa” - Shosh.
10. Çmimin; Dyshja më e mirë e rapsodëve. E fiton; Isuf Rashiti & Mehmet Petrovci.
11. Çmimi; “Dervish Shaqa” (për rapsodin më të mirë të festivalit) . E fiton; Hasan Kqiqi - Mitrovicë.
12. Çmimi; “Muhamet Malsori” (për solistin më të mirë të festivalit) . E fiton; Rexhep Jashari - Gjilan.
13. Çmimi “Nexhmije Pagarusha” (për solisten më të mirë të festivalit) . E fiton; QK “Anamorava”, Merita Sahiti – Selishta - Viti.
14. Orkestra më e mirë. E fiton; SHKA “Tingujt e Vendlindjes” - Stagovë / Kaçanik.
15. Çmimi; “Ndue Shyti” (për instrumentistin më të mirë) . E fiton; Tom Marvukaj – Malësi e Madhe.
16. Çmimi; Kënga më e mirë polifonike. E fiton; Grupi Polifonik “Krojet e velçës” - Vlorë.
17. Çmimi; Teksti më i mirë të këngës epike. E fiton; “Në Mitrovicë na rrehi teli” - Daut Zymeri – Godanc / Shtime.
18. Çmimi; Teksti më i mirë të këngës lirike. E fiton; “Këngë kanagjegji”, SHKA “Zëri i Llapushës” - Carrallukë / Malishevë.
19. Çmimi; Interpretimi më autentik. E fitojnë; Ikli Punavija, Elmir Berisha dhe Berat Krasniqi.
20. Çmimi “Hajrush Kryeziu” (për vlerësimin më të mirë nga publiku). E fiton; Ansambli i Këngëve dhe valleve “Deçani” - Deçan.
21. Çmimi : Për korrektesi dhe ruajtje të traditës. E fiton; SHKA "lirët" - Llozanë / Zvicërr.
22. Vendi i tretë. E fiton; SHKA “Rapsha” – Drume, Tuz, Malësi e Madhe – Mali i Zi.
23. Vendi i dytë. E fiton; SHKA “Rapsodia e Sharrit” -Tetovë.

**24. Vendi i parë - Çmimi; “Anadrini Folk” (për grupin me tërësinë më të dalluar programore). E fiton; SHKA “Dardania” – Winterthur / Zvicërr.**




Më pas pas dizajnimit të çmimeve të festivalit “ANADRINI FOLK 2020” u shtypen edhe çmimet po ashtu në mënyrë virtuale prej nga secili mund të krenohet me arritjet e veta dhe të pjesëmarrësve të këtij festivali shumë të qëlluar.

Ja se çka shkrou drejtori i festivalit Xhafer Bytyqi lidhur me ketë:

“Një listë e gjatë e çmimeve për t’iu dhënë vlerësimet e merituara të gjithë atyre që merituan të jenë të vlerësuar po e përcjell përfundimin e këtij festivali.

Edhe ata që nuk morën vlerësime të drejtpërdrejta, padyshim që sollën program të mrekullueshëm, duke bërë që përcjellësit virtual të festivalit të kënaqen dhe të shprehin admirim për ta.

Videot me program garues arritën që të përcillen nga 2-3 mijë deri në mbi 50 mijë përcjellës virtual, për ta bërë festivalin e parë virtual kombëtar të folklorit Anadrini Folk festivalin folklorik më të shikuar në kohë reale.

Në çdo festival ka gabime edhe pakënaqësi në vlerësime por vlerësimet e jurisë profesionale të festivalit Anadrini Folk 2020, në bazë të përvojës time në organizimin e festivaleve ku për 15 vjetë isha në rrethin e ngushtë të organizatorëve dhe për tetë vjetë isha drejtor i festivalit folklorik “Anadrinia Jehon” si dhe bazuar në zhvillimet e
festivaleve tjera ku kam përcjellur dhjetëra të tillë, mendoj se vlerësimet e jurisë profesionale e festivalit të parë virtual Anadrini Folk 2020, janë vlerësimet më të sakta dhe më të qëlluarat.

Prandaj, ndjej kënaqësi për këtë përmbyllje të suksesshme të festivalit Anadrini Folk 2020, njëkohësisht të gjithë fituesit i uroj për çmimet e fituara dhe bashkë me të gjithë pjesëmarrësit tjerë të festivalit i




inkurajoj që të kultivojnë edhe më shumë kulturën e bukur shpirtërore të popullit shqiptar, përmes së cilës po ipet një kontribut i pakontestueshëm në zhvillimin e atdhedashurisë tek gjeneratat e reja.

Gjithashtu shprehi kënaqësinë time që festivali virtual Anadrini Folk 2020 ka arritur që të depërtojë në të gjitha familjet shqiptare dashamirëse të folklorit, duke i argëtuar dhe duke i'u lehtësuar ditët e karantinës nga pandemia globale Covid 19". Pas ndarjes së çmimeve natyrisht se pati edhe debate dhe analiza të jurisë, shoqërive, shoqatave e pjesëmarrëve tjerë lidhur me iden, kriteret, pjesëmarrjen, mandej vlerësimet dhe shumë e shumë tema të këtij lloji, ashtu si që ishte në vet lokalet e SH.K.A "DARDANIA" gjatë ushtrimeve të saja që mbretëronte një atmosferë e veqant me vlerësimin për vendin e parë.

"Jemi shumë krenar që juria na kanë vlerësu pikërisht neve, andaj ne ju jemi mirënjëhës, edhe jurisë edhe organizatorëve që na kanë mundësu të marrim pjesë në këtë festival kështu" u shprej anëtarja e kryesisë Enisa Hoti, për të vazhdua edhe më tutje me ambicjet e mëdha që ka kjo shoqëri për festivale dhe mundësia e kufizuar për të marrë pjesë në to.

Andaj veterani Hamit Shillova që zotëron veglat me frymë, por jo vetëm kaq, zotëron këngën rapsodike dhe veglat instrumentale thuaja se të gjitha, ai mes të tjerash tha: "Ne, besoj se me punë kemi arrit deri te kjo. Pas kaq vitesh angazhim e përkushtim, besoj se e kemi meritu, edhe pse





nuk e kemi prit se do jemi në vendin e parë, por aty dikun" dhe qeshet me vullnet sepse është i kënaqur se kavallat dhe gajda e tij që kishin vulos vendimin e jurisë.

Pa asnjë hezitim kryetari i shoqërisë ishte më se i kënaqur me vlerësimin, sidomos për pjesëmarrësit në ato gjirime por jo vetëm kaq, ai shpërndante informacione edhe të rrjedhave tjera të festivaleve të sivjeme, prej nga edhe mund të mbahen aty këtu në Kosovë e Shqipëri edhe pse pandemia ka blloku gjithëçka dhe nuk po i dihet momentit.

Si do që të jetë ne vazhdojmë me kultuvu traditën edhe kështu në kushte të veqanta dhe në pengesa edhe të kësaj pandemije dhe mbetet prioritet i ynë që ne të vazhdojmë edhe më tutje kultivimin, trashigimin dhe përcjellëjen e traditave tona tek brezi I ri që po lind e po rritet në mërgim, përfundoj kështu Shefqet Cakolli kryetar i kësaj vatre kulturore në Winterthur të Zvicrës.

Shefqet Cakolli
Winterthur, 03.06.2020



WWW.DARDANIA95.CH

Festivale

# Dita e Popujve në qytetin e Winterthurit prezentohet nga Shoqëria Kulturore dhe Artistike „Dardania“



*Grupi i fëmijëve dhe vallja e Buburrecit, që ishte kënaqësi për fëmijët në publik,*

Në vazhdën e aktiviteteve të saja tash e 28 vite të kësaj qendre kulturore me seli në Winterthur të Zvicrës, vikendin që shkoj, pikërisht më 07 maj të shtunën në „Alte Kasserne“ u mbajt festa; „Tag der Völker“ (Dita e Popujve), e cila kishte pauzu për shkakë të pandemisë për gati tri vite, festë kjo e cila mbahet për çdo vit me vite të tëra, dhe që grumbullon thuaja se të gjitha nacionet që jetojnë dhe veprojnë në këtë qytet prej gati 117 mij banorë dhe qyteti i gjashtë në kuadër të Zvicrës.





*Veshje Çame për fëmijë dhe veshje femrash të veçanta nga Medvegja,*

Organizatorët; Interkulturelles Forum në Winterthur, si institucion që merret më shumë me të haujt, kishin bërë pregaditjet me kohë për mbarëvajtjen e kësaj feste tash më tradicionale ku tubon shumë nacione, me kutura dhe tradita të ndryshme, përmes valles, këngës, instrumenteve, artit, veshjeve dhe ushqimeve të popujve nga e gjithë bota që jetojnë në Zvicër, e posaqërishtë në Winterthur, e që historin e kësaj feste e lidhë edhe këtë shoqëri e cila ka marrë pjesë që nga viti 1995, si emërtim tjetër në fillim që quhej; „Fata Mërgana“, me disa pauzime në periudha të shkurtëra, për tu rikëthy edhe kësaj here pas pandemisë. Pikërishtë në ora 14:00 filloj kështu festa e madhe me një fjalim rasti të kryetarit të saj z.Ali Karadas dhe kordinatores zonja Regula Huwiler, për të përfundua në ora 23:00 me një laramani të programit të paraparë sipas organizatorëve dhe në bashkëpunim me shumë shoqatat e ndryshme që kishin paraqit pjesëmarrjen e tyre në zhanre të ndryshme të prezentimit si në valle, në këngë në instrumente, lojra të ndryshme dhe poezi të kombeve të ndryshme së bashku me ushqimet e llojllojshme, duke fillua kështu nga Alevi- Bektaschi me grupin muzikor, mandej me Valeryia Bernikova nga Ukraina, me saksafon, mandej me korin e fëmijëve kurd nga Turqia, grupin e tupanave nga Maroko, shumë gjuhësia nga mbar bota, si nga Kurdistani, Sri Lanka, Sudafrika, Kameruni, mandej vallëzime në kthina të vogla, si dhe prezentime të



*Paraqitje dinjitoze dhe me një gjallëri që zgjoi kurreshtje te publiku i mrekullueshëm,*

veshjeve të ndryshme si lidhja e shallit indian, deri te gajdet skandinave, po ashtu nuk munguan as bashkëbisedimet në grupe të disa nga gjuhët si; turqishtë, spanjollishtë, tamilishtë, greqishtë, shqipë, arabishtë e kurdishtë.

Kështu që pjesa e dytë dhe festive ishte lënë në mbrëmje edhe ate nga ora 19:00 në sallën e madhe me dekorime dhe bynen e regulluar për paraqitjen e grupeve të vallëzimit, këngës e grupeve të instrumenteve dhe koreve, si dhe paraqitjeve individuale.
Kështu në një atmosfer festive filluan grupet e paraqitura të ngjiten në sken sipas programit, duke fillua me grupin e vallëzimeve nga Meksika, mandej grupi kurd me vallet e tyre, grupi nga Maroku, mandej vallëzimet e grupit të fëmijëve tamil, për të patur një pauz të shkurtës prej gjysëm ore, sa për të patur kohë ti shijojnë të pranishmit e stërmbushur në sallë ushqimet e nacioneve të ndryshme, mes tyre edhe të shqipëtarëve e cila ishte kujdesur zona Feime Jashari, nga shoqata e Gruas në Winterthur, prej nga ishte falenderuese që po prezentoheshim edhe ne shqiptarët me traditat tona, përmes valles dhe kulturës sonë kombëtare, përmes fëmijëve që po lindin dhe rriten në mërgimë.



Pas kësaj pauze të vogël filluan prap të ngjiten në skenë grupi Alevite- bektashiane me grupin e tyre muzikor, ku interpretuan disa instrumentale të traditës së tyre me të rinjët që jetojnë dhe veprojnë në mërgatë, më pastaj vjen grupi tjetër i shoqatës Alevite me këngë dhe kor të të moshuarëve, për të ju ardhë radha Shoqërisë Kukturore dhe Artistike „Dardania“ të cilët ishin në një numer tejet të madhe në krahasim me paraqitjet e më parëshme, duke fillua nga më i vogli me veshje çame, e deri te më i madhi me veshje të trevës së Kosovës, mes tjerash edhe me veshje të Medvegjës.



*Vallja e grupit të të rriturëve, me një përkushtim,*





*Prezentim nga kultura e Senegalit dhe grupi i përbashkët i Ditës së Popujve*

Pasi moderatorja Margarita Lajqi, prezentoj shoqërinë kulturore dhe artistike Dardania, me emocione, sepse edhe ajo vinte nga rrënjët e saja në Kosovë, dhe ndjehej e ngazëlluar gjatë prezentimit, kur edhe u ngjiten në sken anëtarët e kësaj qendre kulturore së pari me dy valle të grupit të fëmijëve, si vallen e Lokut dhe vallen e buburrecit, që ngriten peshë sidomos te fëmijët e paranishëm, por edhe te të mëdhejt me duartrokitjet e vazhdueshme, deri te dy vallet tjera të grupit të të rriturëve si; vallja e Gollakut dhe vallja me motive Tiranase, që performuan gati në mënyrë profesionale të një ansambli me traditë, prej nga asnjëhere nuk munguan qaste ngazëllimi nga publiku që kishte patur kohë e nuk kishin patur rastin të shofin një prezentim kaq dinjitoz dhe kompakt të vlerave tona kombëtare, para gjithë atyre të pranishmëve në sallë, duke përfëshirë këtu edhe atmosferën që po mbretëronte në fytyrat e publikut. Në përfundim të pjesës së progrmait të shoqërisë Dardania, valltarja Besiana Mazrekaj, përshëndeti të pranishmit dhe dha një historik të shkurtët të shoqësisë, prej nga po ashtu u duartrokitë nga masa.

Natyrisht se kishte edhe bashkëatdhetar tanë, që kishin ardhur ta përcillënin këtë fest, disa nga ata edhe me fëmijë të veshur në kostume kombëtare, ku në ta vërehej një krenari që po prezentoheshin në mesin e shumë nacioneve dhe që po duartrokisnin të gjithë pavarësisht kombit e nacionit, qoft edhe zviceranët që njëri nga ta na foli fjalë

miradije për paraqitjen e shqiptarëve me kaq madhështi dhe gjallëri, duke fillua nga më i vogli deri te më i rrituri. Edhe prindërit që moren pjesë në këtë paraqitje ishin tejet të kënaqur me prezentimin dhe punën e pa lodhëshme të stafit të shoqërisë, si dhe punën e koreografes Norës si dhe asistentes së saj Dhuratës, të cilat kishin punua me grupin e fëmijëve, edhe nën masa të pandemisë.

Festa vazhdoj edhe me prezentime të radhës, si Senegali, dhe krejt në fund grupi i përbashkët i popujve me disa Natyrisht se kishte edhe bashkëatdhetar tanë, që kishin ardhur ta përcillënin këtë fest, disa nga ata edhe me fëmijë të veshur në kostume kombëtare, ku në ta vërehej një krenari që po prezentoheshin në mesin e shumë nacioneve dhe që po duartrokisnin të gjithë pavarësisht kombit e nacionit, qoft edhe zviceranët që njëri nga ta na foli fjalë

miradije për paraqitjen e shqiptarëve me kaq madhështi dhe gjallëri, duke fillua nga më i vogli deri te më i rrituri.

Edhe prindërit që moren pjesë në këtë paraqitje ishin tejet të kënaqur me prezentimin dhe punën e pa lodhëshme të stafit të shoqërisë, si dhe punën e koreografes Norës si dhe asistentes së saj Dhuratës, të cilat kishin punua me grupin e fëmijëve, edhe nën masa të pandemisë.

Festa vazhdoj edhe me prezentime të radhës, si Senegali, dhe krejt në fund grupi i përbashkët i popujve me disa për ta përfundua kështu edhe këtë festë tradicionale dhe mjaft e munguar pas pandemisë që kaploj thuaja se gjithë boten.

Winterthur, 08.05.2022, Teksti dhe fotot: Shefqet Cakolli







*Publiku i interesuar edhe për gjirime gjatë paraqitjes së SH.K.A „Dardania" në Winterthur*

# SH.K.A „Dardania“ përfaqësoj shqipëtarët në fetivalin e nacioneve në qytetin e Winterthurit!

***Në të njejtën ditë ajo mori pjesë në dy paraqitje, njëra në festivalin e nacioneve Winterthur, dhe tjetra në koncertin «Skenderbeu na bashkonë» në Luzern!***

Në vazhdën e aktiviteteve të saja tash më të 30 viteve të kësaj qendre kulturore me seli në Winterthur të Zvicrës, vikendin që shkoj, pikërisht më 13 prill, apo të shtunën që shkoj në „Alte Kasserne“ u mbajt festa; „Tag der Vielfalt“ (Dita e Diversitetit), e cila njëherit mund të themi se është një festival i nacioneve të cilat jetojnë dhe veprojnë në Winterthur me rrethinë, e që kishte një pauzë në kohën e pandemisë për gati tri vite, dhe tani kjo pas pandemisë është e treta me radhë, festë kjo e cila mbahet për çdo vit me vite të tëra, dhe që Shoqëria Kulturore – Artistike «Dardania» ishte me vite të tëra pjesëmarrëse, kur ishte me emërtime të ndryshme, duke fillua nga „Fata Morgana» e deri sot me emëtimin e ri. me paraqitjen e grupeve të valleve dhe këngëve të shumë nacioneve të ndryshme pjesëmarrëse.

Një fjalim rasti e bëri kryetari i forumit z. Ali Karadas dhe kordinatores zonja Barbara Tribelhorn, e cila njëherit luajti edhe rolin e moderatores gjatë prezentimit të grupeve në skenë. Mbrëmjen e këtij festivali e nderoj edhe kryetari i qytetit Michael Künzle, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i faleminderoj organizatorët për ftesën dhe mundësin që të gjitha nacionet të shpalosin kuturën e vet, pse jo edhe me ushqime tradicionale.



*Paraqitje dinjitoze dhe me një gjallëri që zgjoi kureshtje te publiku i*

Pikërishtë në ora 14:00 filluan kështu festa e madhe me projektet e pregaditura sipas marëveshjeve të më parëshme, ku edhe përfaqësimi i shoqërisë ka qenë thuaja se në të gjitha mbledhjet deri në realizimin e saj këtë vikend që e lamë pas, dhe që ishte vërtet një gjallëri me ushqime, me lojra e przentime të ndryshme të grupeve të pjesëmarrësve në projekte dhe të pranishmëve që kishin ardhur ti përcillënin të gjitha këta deri në ora 18:00 të mbrëmjes për të vazhdu kështu me programin e mbrëmjes, Organizatorët e përherëshëm; Forumi Interkulturor në Winterthur, në bashkëpunim me qendrën kulturore „Alte Kaserne» dhe në mbështetje të qytetit të Winterthurit, ku si organizatore merren me të haujt, dhe që kanë bërë pregaditjet me kohë për mbarëvajtjen e kësaj feste tash më tradicionale ku tubon shumë nacione, me kutura dhe tradita të ndryshme, përmes valles, këngës, instrumenteve, artit, veshjeve dhe ushqimeve të popujve nga e gjithë bota që jetojnë në Zvicër, e posaqërishtë në Winterthur, e që

historin e kësaj feste e lidhë edhe këtë shoqëri e cila ka marrë pjesë që nga viti 1995, si emërtim tjetër në fillim që quhej; „Fata Morgana“, me disa pauzime në periudha të shkurtëra, për tu rikëthy edhe kësaj here pas pandemisë.



*Publiku i interesuar edhe për gjirime gjatë paraqitjes së SH.K.A „Dardania“ në Winterthur*





*Kryetari i qytetit Michael Künzle, kryetari i Forumit, Ali Karadas!*

Rastisi po ashtu që dy kryetarët ai i qytetit, dhe i SH.K.A „Dardania“, të shkëmbejn pak biseda të ndërsjellëta dhe përshëndetje të ngrohëta, gati si dy miqë që njifen ka here, dhe që thuaja se na viziton sa herë që shoqëria e fton në manifestime të përvjetoreve të saj, me çka u njoftu edhe për këtë vit, me rastin e 30 vjetorit të themelimit të saj, që do të mbahet më 30 nëntor.

Kësaj radhe programi që kishte fillua nga ora 14:00, ishte planifiku të përfundonëte në ora 22:00 me një laramani të programit të parapar sipas organizatorëve dhe në bashkëpunim me shumë shoqatat e ndryshme që kishin paraqit pjesëmarrjen e tyre në zhanre të ndryshme të prezentimit si në valle, në këngë në instrumente, lojra të ndryshme dhe poezi të kombeve të ndryshme së bashku me ushqimet e llojllojshme, duke fillua kështu nga Alevi-Bektaschi me grupin muzikor, mandej shoqatën e grave kurde, valle të fëmijëve tamil, për të vijua me Filipinën , si dhe lojra fëmijësh me ngjyra mandej vallëzime greke, me gjuhë dhe si nga Ukraina, Anglia,Ukraina Spanja, Somalia, Afganistani, Rumania, Shrilanka, e shumë e shumë nacione tjera, por nuk munguan as biseda e familjeve shqiëtare me Violetën nga Shqipëria dhe ushqimet tradicional të Feime Jashari, e cila ishte prezent në dy projektet nga ora 14:oo dhe nga ora 18:00 në sallën e madhe në kuadër të Shoqërisë Kulturore dhe Artistike «Dardania», e cila po paraqitet me valle si gjithënjë.



*Këndi i ushqimeve tradicionale të shqipëtarëve!*

Kështu që pjesa e dytë dhe festive ishte lënë në mbrëmje edhe ate nga ora 19:00 në sallën e madhe me dekorime dhe bynen e rregulluar për paraqitjen e grupeve të vallëzimit, këngës e grupeve të instrumenteve dhe koreve, si dhe paraqitjeve individuale, andaj edhe ishte planifikua me kohë që kësaj here të mos mbetemi deri në orët e vona të natës.



*Grupi i vajzave me vallen kosovare*!

Kështu në një atmosfer festive filluan pikat dhe prezentimi i grupeve, me një publik të stërmbushur, ku grupet e paraqitura ngjiteshin në skenë sipas programit, duke fillua me grupin e vallëzimeve nga Greqia , mandej grupi i fëmijëve Tamil, për të na ardhë radha e grupeve të Shoqërisë Kulturore dhe Artistike, „Dardania“ , me një prezentim të shkurtër të valleve tona nga koreografja e shoqërisë Arbnore e Dhurata Cakolli dhe Besiana Mazrekaj, duke e përfaqësu kulturën dhe valle tonë shqipe të thuaja se të gjitha tokave tona, me *vallen e vajzave Kosovare* të grupit të vegjël, për të vazhdu me *vallen Tiranase* të grupit të mesëm, dhe për të vijua me grupin e vajzave të rriturave me *vallen e Dukagjinit*, për ta rrumbullakësuar gjithë programin prej 30 minutash, me grupin e të rriturëve me *valle çame*, që në një farë mënyre nuk patem edhe konkurim edhe për nga numri i anëtarëve dhe stilin e valleve por edhe veshjeve të lloj-llojshme që përfaqësuam si veshje burimore të secilës valle veq e veq!



*Grupi i mesëm me vallen Tiranase!*

I gjithë publiku ishte në vëmendje dhe në gjirime nga telefonat e tyre dhe asnjëhere nuk munguan qaste ngazëllimi nga publiku i mrekullueshëm që kishte kohë e nuk kishin patur rastin të shofin një prezentim kaq dinjitoz dhe kompakt të vlerave tona kombëtare, para gjithë atyre të pranishmëve në sallë, duke përfëshir këtu edhe atmosferën që po mbretëronte në fytyrat e publikut, dhe duartrokitje që po jepnin thuaja se pas çdo përfundimi të valleve tona.



*Grupi i të rriturëve në vallen e Qame!*

Programi vazhdoj me gratë kurde me vallet e tyre, mandej grupi Alevi. Bektashi, që në radhë të ngjitet në skenë edhe grupi meksikan me një kolorit dhe valle atraktive si që dinë ata, për ta përfunduar me valle të grupit të grave nga Filipinet me një kërcil tradicional të tyre.

Natyrisht se kishte edhe bashkëatdhetar tanë, që kishin ardhur ta përcillënin këtë fest, disa nga ata edhe me fëmijë të veshur në kostume kombëtare, ku në ta vërehej një krenari që po prezentoheshin në mesin e shumë nacioneve dhe që po duartrokisnin të gjithë pavarësisht kombit e nacionit, qoft edhe zviceranët që shumë nga ata na folën fjalë miradije për paraqitjen e shqiptarëve me kaq madhështi dhe gjallëri, duke fillua nga më i vogli deri te më i rrituri.

Edhe prindërit që morën pjesë në këtë paraqitje ishin tejet të kënaqur me prezentimin dhe punën e pa lodhëshme të stafit të shoqërisë, si dhe punën e koreografes Norës, Besianës si dhe asistentja Dhurata, të cilat kishin punua me grupin e fëmijëve, por edhe me të rriturit, prej nga vërehej kujdesi për mbarëvajtjen, për secilen pikë të paraqitjes.

Vlenë të theksohet se po të njejten ditë, orkestra e shoqërisë, mori pjesë në koncertin e organizuar me moton „Na bashkon Skënderbeu“ edhe ate me tri pika muzikore, të dy këngëve dhe një valle instrumentale, edhe ate: *këngë për Skenderbeun*, kënduar nga Hamit Shillova dhe grupi si dhe *këngën për Adem Jasharin*, kënduar nga Ekrem Beqiri dhe orkestra! Përkundër dëshirës së madhe që të jemi në dy vendet për një here edhe me vallëzime, kështu ishin mundësit kësaj here, edhe pse stafi ynë e ka mbështetur këtë iniciativë, dhe ka marrë pjesë në mbledhjet që janë organizua deri sa u bënë pregeditjet e këtij koncerti ku moreën së paku 15 shoqëri e ansamble nga mbar Zvicra.



*Grupi i orkestrës në koncertin: „Skenderbeu na bashkon“*

Winterthur, 14.04.2024,
Teksti dhe fotot:
Shefqet Cakolli

Winterthur, 02 dhe 03 dhjetor, Jona,

Manifestime

# DARDANIA FESTOJ DY DITË RADHAZI, DITËN E FLAMURIT!




*Ajo u vlerësua për organizimet dhe mbajtjen e festave pa snjë llogari në kurriz të popullatës, andaj vlenë të vlerësohet dhe ndihmohet edhe më tutje edhe nga shteti edhe nga donatorët e veprimëtarit ekonomike që veprojnë në mërgatë!*

Në vazhdën e e aktiviteteve për nderë të festave të nëntorit, të cilat kanë nisur qysh në tetor, për të përfunduar ndoshta edhe në javën e parë të dhjetorit, mund të themi se pati një mori aktivitetesh të shumë llojshme, por shumica prej tyre u organizuan edhe për përfitime komerciale me çka edhe po i humb vlera e festës duke ja ndryshu edhe dedikimin e festës së tij, për ndonjë përfitim sa do qoftë ai.
Për dallim nga të gjitha këto nuk ishte edhe në Winterthur të Zürichut, pikërisht në Hotel Zentrum Toos, ku Shoqëria Kuturore dhe Artistike Dardania, kishte ftua musafirë të ndryshëm të Shqipërisë, të Kosovës, dhe thuaja se të gjitha ansamblet dhe shoqërit kulturore, si dhe dy shkollat shqipe në Zvicër, dhe korin diplomatik prej të cilëve ju kishin ardhë vetëm nga konsullata e Republikës Kosovës në Zürich, me në krye me konsullin e sapo emëruan z. Vigan Berisha, ud. të konsulles zonjen Arjeta Gallapeni, e cila ushtroj detyren deri erdhi z. Berisha, si dhe zv.konsulli Avni Zejnullahu, i emëruar para disa muajsh.



Edhe përkundër motit të vështirë me borë e ngrica, salla ishte e stërmbushur me publik, e të ftuar të cilët kishin zërë vendet edhe me rezervime, por që i ngjante një salle teatri spo koncerti pa tavolina, gjë që ndikoj në vëmendjen e publikun vetëm në skenëne cila ishte dekoruar në mëryrë perfekte krejt në dedikim festës së flamurit dhe vatrës sonë të lënë me dekada.
Me një inskenim të pregaditur nga udhëheqësi artistik, tash më i sprovuar të kësaj qendre kulturore, ku zgjoi pak emocione me nunullën dhe fëmiun në djep, duke e vu në gjumë djalin e saj , me ninulla për heroi tonë kombëtarë, për Ismail Qemajlin, e Isa Boletinin, natyrisht duke e përcjellë nga burri me kavallë dhe vajza duke e qëndisur flamurin, pranë një oxhaku që ishte vu në skenë, që të lente përshtypje se jemi në vendlindje, pas së cilës ninullë vijn tupanat me një melodi dasme, për tu radhit të gjithë anëtarët e shoqërisë për hymnin kombëtarë, me çka ju këndua edhe nga anëtarët e shoqërisë dhe publiku në sallë.




Moderimi i shkëlqyer i Albulena Kqikut, bëri që ta hapë festën e flamurit dhe në emër të shoqërisë, ti përshëndes të gjithë të pranishmit, e sidomos të ftuarit si; ud. të konsulles në Zürich zonjen Arjeta Gallapeni, zv. konsullin Avni Zejnullahun, si dhe tani i sapo ardhur në detyrë të konsullit të Republikës së Kosovës në Zürich z. Vigan Berishë, e që këtë pasi u ftua kryetari i shoqërisë Dardania, e përshëndeti, dhe i uroj mirëse ardhje, pasi që ishte ardhur para dy dite në detyrë.
Moderatorja vijoj me përshëndetjen e të pranishmëve si: LAPSH-in me Naser Ulajn, dhe Shkollën Shqipe të Zvicër me Vaxhid Sejdiun, mendej Dr. Dashnim Hebimin, publicist, gazetarë dhe doktor i shkencave politike, i cili kishte sjellë me vete edhe z. Rafet Ademin nga Tërnoci i Luginës së Preshevës, kryetar i Shoqatës Frick në Kt. Argau, përfaqësues të Institutit Shkencor Helvetik të Evropës Juglindore me seli në Zvicër, për të vazhduar me shkrimëtarin Brahim Avdylin dhe gazetarin Rexhep Rifatin të cilët edhe ekspozuan librat e tyre në hollin e sallës.
Nga shoqërit dhe ansamblet u përshëndetën: Shkolla Shqipe e Vallëzimit Shota, në krye me Lirije Bajramin, bashkëshortja e të ndejrit Agron Bajrami, mandej Ansamblin Vatra nga Büllachu, Shoqatën Bashkimi nga Usteri, Shoqatën Sharri, Grupin Teatral Aktrimi, nga Zürichu, shoqatën Plisat nga Dübendorfi, si dhe disa shoqata tjera që ishin prezent në sallë.

Nga donatorët e kësaj feste u përshëndeten dhe u faleminderuan nga organizatori, përmes moderatores e cila edhe kujdesej për mbarëvajtjen e programit, ajo i faleminderoj të gjithë ata që kishin kontribua për shpenzimet e sallës dhe kishin bërë të mundur që hyrja të jetë falas si çdo here për publikun, edhe pse tani thuaja se






të gjitha organizimet po bëhen me pagesë në hyrje për festat kombëtare!
Festën e madhe të 28 Nëntorit, ishin ftuar nga organizarori edhe dy mediat tona kombëtare RTSH-ja dhe RTK-ja me përfaqësuesit e tyre, z. Lesh NIkolli, në cilësin e gazetarit dhe lavdim Klaiqi po ashtu në cilësin e kameramanit dhe gazetarit, prej nga u përshëndeten nga moderatorje në emër të organizatorit të këtij manifestimi.
Me respekti më të madhë ajo i lexoj donatorët e festës duke fillua nga sponsori kryeror i kësaj feste si: Budget Group, BeFi AG Reinigung, Daka Paint, Kim Bildhauer, Mataj Selfgarage GmbH, SLDI Autospritzwerk, Hotel Zentrum Töss, Restoraunt Gutschick, Malësia Reisen dhe City Taxi, ku në fund të programit artistik, kryetari ju ndau edhe nga një mirënjohje, jo vetëm donatorëve por edhe tre përfaqësuesëve të mediave, si: Llesh Nikollit, Lavdim Klaiqit dhe Fidan Shahinit nga Saini Produktion, që e ndihmon këtë shoqëri me xhirime dhe foto.

Pas përshëndetjeve në skenë u ftua kryetari, tash më 29 vite z. Shefqet Cakolli, dhe me tu ngjitur në skenë si në shaka kërkoj që të zavendësohet nga dikush nga kjo sallë për të vazhdua shoqëria rrugëtimin e vetë, sepse po afrohen 30 vite veprimëtari dhe ju premtoj të pranishmëve që edhe 30 vjetorin do ta festojm bashkë e më pastaj, do e vazhdoj dikudh tjetër.

Natyrisht se ai potencoj edhe rëndësinë e 28 nëntorit, duke i thënë vetëm pak fjalë me simbolikën e 111 vjetorit të Pavarësisë dhe ditës së Flamurit, duke i nda tre njishat me Gjergj Kastriotin - Skenderbeun në Kruj, me Ismail Qemajlin e Isa Boletinin në Vlorë dhe me Adem Jasharin në Prekaz, ai ju uroj gjithë shqipëtarëve festën e flamurit me porosin e tij tashmë të njohur; "Zot ruaji shqipëtarët nga sqipëtarët".

Me njëhere u ftua edhe zonja Arjeta Gallapeni, si ushtruese e detyrës së konsulles në Zürich e cila foli për rëndësin e flamurit dhe shoqatave që po ruajn vlerat kulturore në mërgatë si kjo në Winterthur, me një përkushtin të madhë të aktivistëve të saja.






Me një here pas dy fjalimeve të shkurtëra, moderatorja i ftoj në skenë grupine vallëtarëve të rriturit me një mozaik vallesh, të pregaditura nga të gjitha trevat tona, por edhe të kostumeve të lamishme të thuaja se të gjitha zonave tona kombëtare, dhe karakteret e tyre simbolike.

Më pastaj u ftuan më të vegjëlit të cilët, filluan me këngën "Mora fjalë", të cilët këndua bashkë me publikun, për të vijua me vallen me motive të Shqipërisë së mesme, premier për sonte, luajtur nga grupi i të mesmëve, me lëvizjet e tyre tipike tiranase, prej nga e bukura e gjithë kësaj vallje ishin edhe veshjet enkas të Tiranës me rrethinë.

tyre, dhe duke u kënaq me lëvizjet dhe inskenimin e kësaj kënge të mrekullueshme, ekzekutuar nga i gjithë grupi i të vegjëlve.

Në skenë u ftuan me një sofër pran oxhakut, me simboliken e vetë të një sofre të zbrazët se kjo shoqëri donë përkrahje edhe më tutje nga shteti dhe donatorët për të pasur kësi lloj festash për popullin e gjërë pa asnjë çmimë hyrës si deri më tani. I gjithë grupi prej shtatë vetash të orkestrës që vepron që nga themelimi, dhe që kanë kalua këngëtar e këngëtare nëpër këtë vatër dhe sofer të traditës sonë përmes këngës, të cilët i kënduan kombit shqipëtarë dhe trojeve tona, kënduar nga Hamit




Ata vijua më pastaj me gjithë grupin e të vegjëlve me një kollazh vallesh për fëmij, ku u përfëshinë të gjithë ata që po e zotronin këtë valle, pse jo edhe më të vegjëlit e shoqërisë.
Krejt në fund të bllokut të fëmijëve, ata e kënduan këngën " N`gjamadan vija vija" që zgjoj kurreshjte dhe krenari sidomos te prindërit e tyre, duke i xhirua me telefonat e

Shollova, mandej duke i kënduan flamurit dhe pavarësisë me Sylë Sylajn, dhe Adem Jasharit, kënduar nga Ekrem Beqiri, duke u përcjellë që në fillim me një valle instrumentale nga e gjithë orkestra edhe të Tefik Shavdës me def, Dorart Ahmeti, me sharki, Musli Lecaj me çifteli, dhe për fund me një valle me kavalla të mjeshtrit t`madhe Hamit Shillova përcjellë edhe nga Mehmet Sermaxhaj.

Natyrisht se festa e 28 nëntorit dhe skenarii organizimit kishte paraparë edhe femijët e shoqërisë me vjershat dhe recitimet e tyre, për të fillua me aktorin dhe regjisorin e njohur nga Shqipëria z. Llesh Nikolli, i cili interpretoj recitalin e tij për Kosovën, me shumë emocione te interpretimit dhe publiku, për të vazhdua me: Raja Ademi, Sara e Lejla Grabovci, Anea Sermaxhaj, Norik Sermaxhaj, Mael Kqiku, Anik Sermaxhaj, dhe Enes Avdyli.

Pas vjershave të bukura dhe që moren duartrokitje nga prindërit dhe publiku i mrrekullueshëm që mbanin qetësi dhe ishin koncentru kah byna, moderatorja ftoj në skenë grupin e vallëtarëve të rriturit me vallen myzeraqe, premier për sonte të cilën e kishte thurë mjeshtri i madh i korografisë Gëzim Alimehmeti, dhe që vetë asistentët e shoqërisë e kishin ushtrue me muaj, që sot të kompletohet e tëra, bile e dhe me veshje të veqanta për ate zonë, prej nga zgjoj një kurreshtje te të shumë të pranishmëve, me interperetimin dhe një lloji të tillë të trevës së Lushnjes dhe valleve myzeqare. Nga kutura dhe njohësit e mirë të valleve dhe veshjeve vërtet pati komente e vlerësime të mira sidomos të po kësaj vallje për guximin që kjo shoqëri ka arrit me punua një valle të tillë.



Aty edhe pse koha me ngrica dhe një të diele pushimi, organizatorët ishin mobilizuar në mbarëvajtjen e festës së flamurit, edhe në këto anë, prej nga shumë nga prindërit dhe të ftuarit tjerë po merrnin pjesë në këtë datë të madhe të kombit tonë. Moderimi nga Agim Sylejmanit dhe Shpresa Rrahmani-Ida, ishte pikënisja, para një inskenimi me ninullën si në Winterthur, dhe hymnit kombëtar, që



performoj me së miri, për tu ftuar edhe nga organizatori dhe fjale e tij e rastit të z. Ilmi Cakolli, mandej të folësve të tjerë si mësuesit Rexhep Nezirit, etj, që më pas filloj edhe programi artistik i shoqërisë së ftuar, e cila e përsërit të njejtin program edhe në Jona të St. Gallenit.
E tëra mund të themi se e gjitha kjo pati jehonë të madhe në mediat e shkruara, dhe media vizuele, të cilat e plasuan shkrimet e tyre si Bota Sot, dhe gazetarin e njohur Dashnim Hebibi, të Mefail Maliqit nga Gjeneva, të emisioneve RTSH, dhe emisioni Ura, mandej pritet të palsohet edhe në mediat tjera varësisht nga ata që shkruajn dhe raportojnë mbi këto ngjarje të rëndësishme të kombit tonë!

Nga Kosova ishte djellur edhe një film i shkurtër nga lavdim Klaiqi, përmes Mobikono, sa për ta thyer pakëz rendin folklorik, por edhe për të fituar hapësirë për veshjet dhe vallen çame e cile edhe ishte vallaj e fundit në këtë manifestim, për të vijuar më pastaj me muzikë të orkestrës me surla e tupane, për publikun e gjërë bashkë me vallëtarët të cilët zbriten nga skena për në sallë me ju bashkangjit publikut dhe atyre që donin pakëz me vallëzua vetëm shqip!

Kështu ishte edhe të nesërmen në Jona të St. Galleni, organizuar nga Lëvizja Vetvendosje, pikat: Oberseen, St. Gallen, Luzern, dhe Thurgau, të cilët me kohë kishin ftuar shoqërinë kulturore dhe artistike Dardania nga Winterthur, për programin artistik thuaja se të njëjtin nga ai i festën në Winterthur.

Winterthur, 04.12.2023

Sociale

# NË SCHMERIKON TË ZVICRËS, U ORGANIZUAR PIKNIK E TURNIR, BASHKË ME KULTURË!

***Pikniku, pak politikë, kultura, ushqimet tradicionale, dhe futbolli i tuboj mërgimëtarët në fundjavën që shkoj!***

Fundjavën që lamë pas ishte atmosferë feste të një pikniku dhe të turnirit të futbollit që u organizua me shumë sukses duke i falenderuar gjithë atyre që moren pjesë, në veqanti Këshilli Organizativë i Pikës Obersee, si organizatore, e cila ishte angazhuar gjatë gjithë kohës në shërbim të 150 pjesmarrjësve në piknik që u mbajtë në ambientet e fushës së sportit, FC Schmerikon (SG).

Në këtë piknik – turnir po merrnin pjesë edhe tre deputet të parlamentit të Kosovës, Mefail Bajqinovci, Adriana Matoshi dhe Dimal Basha, të cilët bashkëbiseduan me të pranishmit për tema të ndryshme që ndërlidhen me situatën politike në Kosovë dhe sukseset e Qeverisë Kurti, prej nga u faleminderuan nga kryetari i pikës z. Ilmi Cakolli, për pjesëmarrjen e tyre dhe fjalën e rastit.

Pjesëmarrës ishte  edhe kryetari i Unionit të Klubeve të Futbollit Shqipëtar në Zvicër z. Feti Demolli,  si aktivist i kësaj pike dhe njëherit anëtarë i këshillit organizativ, si dhe Kushtrim Berisha, deputet kantonal i kantonit të Schwyzit nga partia socialdemokrate.



Po ashtu ai falenderoj edhe  SH.K.A „Dardania“ nga Winterthuri e cila paraqiti një  program modest kulturor para të pranishmëve, me një pjesë të  grupit të valltarëve e më të vegjëve të shoqërisë me këngën: “Mora fjalë”, mandej  vallen me motive Tiranase, si dhe “Vallen e vajzave”, për të vazhdua me një valle të përbashkët ku u bashkangjiten edhe të pranishmit, por edhe të ftuarit nga Kosova.

Pas prononcimeve dhe fjalës së musafirëve nga Kosova dhe disa nga pyetjet bengosëse të mërgatës, për deputetët që ishin prezent,  dhe pas programit artistik, organizatorët kishin paraparë edhe turnirin e futbollit, e cila ishte  po ashtu nënë udhëheqjen e pikës Obersee, si udhëheqëse e këtij  turniri të qëlluar, prej nga u ftuan  të gjitha grupet të vijojnë me lojën dhe turnirin, i cili edhe u zhvillua në fushat



e qendrës sportive të FC Schmerikon, ku në fakt ushtron edhe klubi futbollistik shqipëtar "Bashkimi" prej nga edhe kishte mundësua edhe ambientet dhe lokalet e këtij turniri të organizuar nga kjo pikë e vyeshme.

Natyrisht se organizatorët kishin paraparë edhe kupën fituese të turnirit futbollistik të Qendrës Pika Obersee, dhe pas përfundimit të lojës së ekipeve, ate e fitoj me meritë pikërisht kjo pikë, duke e falenderuar ekipin e shkëlqyer të udhehequr nga kapiteni i ekipit Arsim Zogëjani i cili ishte i organizuari në udhëheqjen edhe prezentimin e ekipit të Pikës Obersee. Vendin e dytë e zuri ekipi fudbollistik i Pikës së Kantonit të Thurgaut, nën udhëheqjen e Argjend Shehut, që ishte edhe në kordinim të turnirit, kurse ekipi i fudbollit fitues të pikës Obersee, nën udhëheqjen e Arsim Zogëjani, vendosën ti dhurojnë kupën e Qendrës Obersee, pikës së Gjenevës që zuri vendin e tretë, në mënyrë që vitin e ardhëshëm, pika e Gjenevës merr për detyrë me organizue turnirin e Qendrës diku në qershor 2025, mundësisht në "Javën e LVV-ës" si na njoftuan organiozatorët e këtij turniri në Schmerikon të St. Gallenit.

Natyrisht se nuk munguan as falenderimet e të gjithë aktivisteve dhe aktivistëve në mbarvajtjen e këtij aktiviteti të Qendrës, si dhe sekretarën e Qendrës, kryesore z. Yllka Kurteshin e cila ka kordinuar me suksesë punën e organizimit së bashku me Pikën nikoqire dhe me sekretariatin e përgjithëshëm në Prishtinë për mundësinë e ardhjes dhe pjesëmarrjen e tre deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje.



Natyrishtë se nuk munguan as ushqimet tradicionale, dhe pije freskuese të gjitha organizuar nga kjo pikë e Lëvizjes, dhe që të gjitha ishin falas për të pranishmit. Mbetet që edhe herave tjera të shihemi me aktivitete të tilla, si deri më tani na tha në fund edhe arkëtari i kësaj pike, Xhemajl Bedrolli, i cili u kujdes që kuzhina dhe pijet freskuese të shkojnë si më së miri falë edhe prindëve që kishin sjellë ushqime tradicionale për këtë piknik – turnir.

Shefqet Cakolli , 26.06.2024 Schmerikon









# DISA NGA PËRSHTYPJET E VOGËLUSHËVE TË DARDANISË GJATË PROVAVE!

***Anik –*** Jamë 10 vjeçar, dhe muzika e tradita shqiptare më pëlqejnë shumë. Jamë krenar që kamë mundësinë ta ndjek dhe mos ta harroj traditën e gjyshërve tanë, edhe pse jetoj në diasporë. Gëzohem çdo javë kur vij në vallëzim dhe takohem me shoqe e shokë për të vallëzu së bashku. Po ashtu unë mburrem kur i veshi veshjet dhe plisin e lasht Iliro- Dardanë, për tu paraqitur nëpër koncerte.

***Amar –*** Unë jamë 10 vjet, dhe mendoj se është mirë në Dardani sepse kamë shumë miq atje dhe është shumë argëtuese që e premtja është gjithëmon dita ime e lumtur. Thjesht më pëlqen të jemë në shoqërinë Dardania, dhe ky është vendi im më i preferuar i të gjitha kohërave!

***Alba dhe Ajla –*** Neve na pëlqen koreografija që na mësojnë te Dardania!

***Arilena –*** Jamë 9 vjeçe, dhe mendoj se atje mësojmë vallëzimin tonë shqip. Të gjithë janë të kujdesëshëm me ne, dhe mendoj se është shumë e vlefëshme që mësojm e vallëzojm shqip tek Dardania!

***Ajana dhe Inara –*** neve na pëlqen Dardania sepse janë traditat e mija. Më pëlqejnë shumë veshjet kombëtare, vallëzimet dhe i tërë grupi i fëmijëve!

***Anuar –*** Jamë 8 vjet, dhe jamë në klasë e parë. Mua më pëlqen Dardania sepse kamë shumë shokë aty, dhe kamë shumë dëshirë me ardhë në Dardani me mësua valle!

***Alessia –*** Jamë 8 vjeçe, dhe këtu në dardani më pëlqen sepse dua që të ruaj traditat shqipëtare. Tradita e cila më mëson të ecim një hap përpara me simbolin e Flamurin tonë kombëtar. Në përgjithësi tradita e trojeve tona është trashigimi nga brezi në brez, për këtë jamë shumë krenare.

***Alea –*** Unë e dua shumë Dardaninë, sepse vallëzojmë shumë mirë !

***Dira –*** Jamë 10 vjeçe dhe ndihem gjithëmon e gëzuar sidomos të premteve në ushtrime !

***Donika –*** Jamë 6 vjeçe dhe shumë e kënaqur që jamë pjesë kësaj shoqërije. Jamë po ashtu e kënaqur me mësueset, Lolin, Dhuraten dhe bacin Shefqet. Kamë lidhur shoqëri të reja atje, dhe po vallëzojm vallet e mësuara shumë mirë. Më pëlqen edhe organizimi i koncerteve dhe festave te kjo shoqëri. Faleminderit shumë që jamë pjesë e juve!

***Eliza –*** Mezi pres me ardhe e premtja të kërcej me shoqet e mija. Mësueset e valleve janë më të mirat, sepse na mësojnë shumë mirë vallet!




***Fjalët dhe vizatimet e fëmijëve të shoqërisë një ndnjenjë e veqant për ardhëmërinë e Dardanisë!***

***Elsa*** – Unë jemë 10 vjeqe, dhe më pëlqen Dardania, sepse mësueset janë shumë të mira. Më pëlqen të vij në Dardani se po ashtu atje kamë miq, dhe është kënaqësia ime të jemë pjesë e saj !

***Elda*** – Unë jamë 8 vjeçe, dhe më pëlqen Dardania sikur që më përlqejnë vallet që na i mësojnë mësueset, ku edhe ndihem jashtëzakonishtë mirë atje !

***Emilia*** – Jamë 6 vjeçe dhe më pëlqen të vijon me kërcy te Shoqëria Kulturore - Artistike Dardania, sepse atje argëtohemi dhe mësojmë akoma më shumë për traditat tona. Më pëlqen po ashtu sepse dita-ditës mësojmë gjëra të reja dhe gjëra akoma më të bukura, qe neve fëmijëve na gëzon, dhe na bënë të ndihemi mirë, me zakonet traditën tonë shqipëtare!

***Erina S*** – Unë jamë e lumtur për ardhjen time në Dardani, dhe jamë e lumtur që për 30 vjetorin e saj do të jemë pjesë e asaj feste të madhe!

***Gentiana*** – Unë jamë 10 vjeçe, dhe ndihem shumë mirë këtu në ushtrime, sidomos të premteve, por edhe në koncerte e fetivale, sepse e dua tej mase vallëzimin!

***Janah dhe Dua*** – Ne jemi shumë me fat, sepse e kemi mundësin të jemi pjesë e Dardanisë. Unë dhe motra ime e vogël e vizitojm me shumë kënaqësi shoqërinë kulturore Dardania, ku personali te kjo shoqëri është shumë e mirë, dhe kështu nuk e harrojmë vendin, kulturën dhe traditën prej nga vijmë, e nga jemi!

***Lejla*** – Jamë në klasën e 5-të dhe jamë 10 vjeçe. Mua më pëlqen shumë në Dardani, sepse ne vallëzojmë në kulturën tonë shqipëtare dhe tradicionale. Më pëlqen po ashtu sepse jemi të gjithë shqipëtarë nga Kosova, Shqipëria, dhe gjitha trojet tona! Më pëlqen po ashtu edhe kënga e recitimi, sepse ne paraqitemi dhe festojmë festat tona nacionale. Faleminderit Dardania!

***Lina*** - Jamë 10 vjeçare, dhe këtu kamë shumë shoqe, ku më pëlqejnë edhe vallëzimet që i bëjmë këtu së bashku!

***Luiza*** – Më pëlqen të vij në Dardani, dhe kamë mjaft shoqe e shokë atje. Unë jamë gjithëmon e lumtur që ti shoh përsëri shoqet, shokët dhe mësueset e mija!

***Raja*** - Uë pres me pa durim të vij dita e premte për të ardhur në ushtrime. Më pëlqen të vallëzoj, por edhe të këndoj, dhe e bëjë me gjithë dëshirën time !

***Nael*** – Unë jamë 7 vjeç. Dardania më pëlqen shumë, sepse unë i kamë mësueset e mira, dhe mundem me u mësua me vallëzu, dhe i kamë edhe shokët e mirë që luajmë e vallëzojmë bashkë. Urime 30 vjerori !

***Mael -*** Jamë 6 vjeç dhe anëtarësimi në Dardani më jep një ndjenjë të fortë identiteti. Në Dardani, unë mësoj për traditat dhe zakonet tona, si këngët dhe vallet që janë të rëndësishme për ne. Aktivitetet e kulturës më ndihmojnë të lidhem me fëmijë të tjerë dhe të krijoj miqësi të reja. Kjo është një mundësi për të festuar origjinën time dhe për të ndjerë krenari për kulturën tonë. Për mua, Dardania është një botë plot ngjyra dhe histori që më bënë të ndjehem si pjesë e diçkaje më të madhe.

***Melina –*** Jamë 9 vjeçe, dhe përpara unë nuk kamë patur iden se çka me bë, dhe kështu nëna ime më ka dërgua te Dardania, ku tani unë mësoj vallet shqipe, dhe ndihem e gëzuar dhe mezi pres të vij e premtja!

***Sara –*** Jamë 8 vjeçe dhe jamë në klasën e 3-të. Mua më pëlqen ardhja në Dardani, sepse këtu vallëzojmë valle shqipëtare, ashtu si më pëlqen që ne jemi të gjithë shqipëtar të lindur në Zvicër, dhe këtu çdo të premte e hjekim shtresin e gjithë javës. Këtu bëjmë edhe aktivitete tjera me mësueset e Dardanisë, por më së shumti më pëlqejn festa e 28 Nëntorit, dhe Pavarësia e Kosovës.

***Yllza –*** Unë jamë gjithëmon e lumtur të mësoj diçka të re në Dardani ! Më pëlqejnë vallet dhe mësueset që na mësoj hapat !








MAHAGONI
M VM Team
ESP GROUP
sotec.
sotec.ch

***Tre afaristët e kulturës dhe traditës sonë, për ti ruajt vlerat tona kombëtar dhe barten te gjeneratat e reja!***




# DISA NGA PËRSHTYPJET E TË RRITURËVE TË SH.K.A „DARDANIA" GJATË PROVAVE!

***Albulena –*** Jamë më tani 30 vjeçe, dhe Dardania ka qenë një pjesë thelbësore e jetës time. Gjatë gjithë këtyre viteve, kamë ndarë momente të paharrueshme me njerëz që ndajnë të njëjtat vlera dhe pasione. Ky vend ka qenë një strehë për traditat tona, për muzikën, artin dhe historinë tonë. Çdo aktivitet, çdo festë, më ka lidhur më fort me rrënjët e mija dhe më ka ndihmuar të ruaj identitetin tim shqiptar. Përveç kësaj, Dardania ka luajtur një rol të rëndësishëm në integrimin timë në shoqërinë zvicerane. Aktivitetet e shoqërisë më kanë ndihmuar të lidhem me kulturën zvicerane dhe të krijoj miqësi me njerëz nga pikëpamje të ndryshme. Kështu, kamë ndjerë se kamë arritur një harmoni mes dy kulturave, që ma ka pasuruar jetën time.

***Ajlina –*** Unë jamë qe gati shtatë vite anëtare e Dardanisë. Është një lumturi e madhe me pas mundësinë për ta përjetuar kulturën time këtu në diasporë. Gëzohem gjithëmon kur vije e premtja me kalua kohën me të tjerët!

***Arlind –*** Te shoqëria Dardania ofrohet një atmosferë e mrekullueshme, ku mund të mësosh shumë rrethë valleve dhe kulturave të ndryshme. Koha këtu është jo vetëm edukative por gjithashtu plot gëzime dhe bashkëpunim, pasi të gjithë anëtarët punojnë së bashku dhe mbështesin njëri tjetrin. Është një mundësi e shkëlqyer për të bërë miq të rinjë për të ndarë pasionin për vallëzim!

***Arbnorja –*** Dardania për mua ka një rëndësi të madhe. Ajo më falë hapësirë ku mund të lidhim kulturën tonë me traditën dhe të njohim njëri - tjetrin më mirë. Aktivitetet dhe ngjarjet tona që i organizojmë ndër vite na ndihmojnë ta ruajmë identitetin tonë dhe të forcojmë komunitetin. Të qenurit pjesë e këtij grupimi, më bënë të ndihem e lidhur me rrënjët e mija tradicionale e kombëtare, ashtu si me njerzë që ndajn të njëjtat vlera. Ndihem krenare që sot po ju mbjellim gjeneratave të reja një kulturë dhe traditë të kombit tonë përmes valles, këngës, veshjes, gjuhës dhe që po e ruajmë identitetin tonë kombëtarë edhe këtu në mërgimë!

***Aurelia -*** Te Dardania jo vetëm që pata mundësinë të bëhem pjesë e një grupi vallëzimi, por gjithashtu përjetova bashkëpunimin e fortë, të cilin e njoh nga kultura shqiptare. Kjo bashkësi dallohet për mbështetjen e ndërsjellë dhe rritjen e përbashkët. Ta ndiej dhe përjetoj këtë lidhje në grupin e vallëzimit Dardania, e bën grupin unik për mua.

***Besniku –*** Dardania është pikëtakimi ku mundohemi me shoqërit e diasporës të flasim, qeshim dhe vallëzojm shqip! Vallet dhe veshjet e ndryshme që na ofrojnë thuaja se nga të gjitha trojet shqipëtare më bëjnë të ndihem krenarë.

***Besiana –*** Shoqëria Kulturore dhe Artistike Dardania është një pjesë e rëndësishme e jetës sime, dhe qe gati 10 vite kjo mu ka bërë edhe familja e dytë. Kjo shoqëri e cila ekziston tash e 30 vite është më shumë se një vend ku ne bashkohemi, dhe është pasioni imë që më mbanë gjallë. Vitet që kamë përjetua këtu më kanë formësuar dhe shpresoj se kjo traditë do të vazhdoj edhe në të ardhëmen. Për mua Dardania do të thotë bashkësi, kohezion dhe mundësi për të ndarë kulturën time me të tjerët, dhe unë




*Koncentrimi psikologjik i bashkëpunimit që sjellë vlera të respektimit të njëri tjetrit!*

jamë duke pritur për gjithëçka që të qonë përpara me traditat tona kombëtare në mërgatë.

***Dhurata –*** Qe 15-të vite për mua e premtja i takon ushtrimeve, me shumë energji, kreativitet dhe mendim që shkon në secilen valle. Është ndnjejnë e pabesueshme si "njerzë të huaj" që si njohim bëhen anëtar të familjes së madhe dhe që e ndajn pasionin e njejt me ne!

***Denisi –*** Për mua shoqëria Dardania është një mundësi e mirë për tu shoqëruar me të tjerët dhe për tu afruar më shumë kulturës sonë shqipëtare. E ndjej gjithëmon si kënaqësi të vij dhe të vallëzoj me të tjerët vallëtarë e vallëtare!

***Edona -*** Unë jamë pjesë e Dardanisë prej gati katër muajsh e më shumë, ose që nga data 14 qershor 2024. Unë ndihem shumë rehat te Dardania dhe gjithëmon pres me pa durim ushtrimet të premteve. Dardania më është bërë pjesë e familjes në një kohë kaq të shkurtër dhe kultura nuk humbet edhe pse jena në Zvicër. Të gjithë tregojnë sjellje respektuese ndaj njëri tjetrit. Urime 30 vjetorin e Dardania jonë!

***Erina R. -*** Unë i kamë 15 vjet, edhe te Dardania jamë ndjerë shumë mirë. Jamë faleminderuse bacit Shefqet, për kontribuitin që e jep për gjithë ne valltarët. Kur kamë ardhë në filim të vitit, me kanë prit valltarët edhe baci Shefqet shumë mireë. Jamë e lumtur që jamë këtu edhe çdo të premte kënaqem shumë këtu me moshataret e mija.

***Erina A. –*** Jamë 13 vjeçe, dhe jamë në Dardani që nga viti 2023, edhe ate pas pushimeve verore. Në Dardani ndihem e kënaqur, ku mujmë të qeshim shumë, sidomos kur kemi momente të mira, prandaj vij me dëshirë në Dardani!

***Erza –*** Unë në shoqërinë kulturore Dardania jamë qe 12 vite. Ndihem shumë e lumtur por edhe shumë krenare që vallëzoj traditen e valleve tona. Ne në fakt jemi si një familje e madhe, dhe ndihem gjithëmon rahat e komodë këtu!

***Era -*** Kur unë shkoj në vallëzim të premten në mbrëmje, harroj të gjitha problemet e javës dhe përqendrohem plotësisht në vallëzim dhe shijoj të gjitha momentet me shoqet dhe shokët e vallëzimit. Vallëzimi më mbush me energji pozitive dhe më motivon për ditët në vijim. Ne kemi një ekip të shkëlqyeshëm dhe kalojmë gjithmonë çaste të mrekullueshme së bashku. Unë jamë tejet e lumtur që jamë pjesë e kësaj shoqërije!

***Fatushe -*** Përshëndetje jamë 22 vjeçe. Në dhjetor 2023 kamë ardhë në shoqërinë kulturore dhe artistike Dardania. Më pritën mirë dhe isha e mirëpritur në grup. Anëtarët marrin kohë për të mësuar dhe për t'ju treguar gjithçka. Dardania ëshë një qendër kulturore ku të rinjët tubohen, dhe me traditat tona kulturore të lloj-llojshme të vallzimit shprehin talentinë e tyre!

***Festimi –*** Dardania për mua është vendi i kulturës, vendi ku mezi të pritet me ardhë fundi i javës, për një qetësim e relaksim nga i gjithë ai shtres i javës dhe përditëshmërisë së lodhëshme në mërgimë!

***Forki –*** Grupi i vallëzimit Dardania është një vend i veqant për mua. Atmosfera është e mrekullueshme dhe çdo anëtar është si një familje për mua. Të gjithë njërzit aty janë të mrekullueshëm dhe ndihmojnë. Njëri tjetrin me shumë dashuri dhe respekt! Vallëzimi në Dardani është po ashtu një përvojë që e vlerësoj shumë dhe më bënë të ndihem pjesë e një komuniteti të ngrohtë dhe mbështetës për secilin prej nesh.

***Iliri -*** Unë ndihem shumë mirë në shoqërinë kulturore dhe artistike Dardania. Aktivitetet që organizojmë janë gjithmonë të këndshme dhe argëtuese. Njerëzit këtu janë si një familje për mua, gjithmonë mbështetës dhe të dashur. Kam krijuar miqësi të forta dhe ndjej një lidhje të veçantë me ta. Dardania është një vend ku mund të shpreh kulturën time dhe të ndaj gëzimin me të tjerët.

***Inola –*** Unë jamë 15 vjeçe, dhe jamë këtu në Dardania për katër muaj, dhe më pëlqen shumë të jemë pjesë e saj. Këtu ndihem rehat, dhe për mua Dardania është një vend ku mund të jemë sikur në shtëpi dhe mendoj se është shumë krenari të jemë pjesë e saj!

***Klodi –*** Jamë anëtar i shoqërisë së vallëzimit qe 12 vite. Më pëlqen këtu sepse krijohen shoqërime dhe ruhet një lidhje e ngushtë me traditën shqipëtare. Është po ashtu kënaqësi të jesh pjesë e një komuniteti që mban gjallë kulturën dhe vlerat tona në diasporë!

***Libade -*** Ka tetë vite që jamë në vallëzim, dhe më pëlqen tej mase dinamika në grupin e vallëzimit e cila më mbushë me shumë energji pozitive, por jo vetëm kaq, aty ne jemi si një familje e madhe!

***Lorena –*** Jamë 14 vjeçe dhe jamë në ansamblin Dardania qe tri vite, dhe këtu më duket shumë i mirë bashkëpunimi si grup dhe shoqëri në përgjithësi. Unë ndihen po ashtu shumë mirë, këtu sepse flasim shqip, dhe më përkujtohet gjithëmon Kosova jonë!

***Mirlinda -*** Unë jamë 16 vjeçe dhe kamë gjysem viti që vij në Dardani. Unë vijë këtu sepse më pëlqen të mësoj diçka nga vendlindja e të parëve tanë. Ndihem këtu shumë rehat sepse njerzit këtu na mbështesin dhe na trejtojnë shumë mirë, sidomos me ne që kemi fillua më vonë, për ta arrit hapin e valleve dhe për tu kyqur në traditat tona.

***Samiri –*** Meqenëse praktikishtë kamë lindur në shoqëri, më lejuan të bëja hapat e mi të parë në emër të shoqërisë. Shoqëria Kulturore – Artistike “Dardania” ka qenë gjithëmon prezent në jetën time, tani më nuk mund ta imagjinoj po ashtu jetën pa te!














*Si këta që mbështesin kuturën dhe traditën tonë kombëtare përmes djemëve e vajzave të Dardanisë mundet secili prej veprimëtarive ekonomike*




# PËRSHTYPJET E GRUPIT TË ORKESTRËS SË SH.K.A „DARDANIA" GJATË PROVAVE!

***Baca Hamit -*** Përshendetje e nderuara SH.K.A Dardania nga Winterthuri! Unë si anëtar i kësaj shoqërije qe gati 30-te vite me radhë, dhe kurrë pa u ndalë duke komtribua për këtë shoqëri, deshta me ju thanë se; në këtë shoqëri e kamë ndije veten gjithëmon të kënaqun, dhe kemi qenë gjithëmon në shërbim të kulturës tonë shqiptare dhe jemi mundua me ba diçka për rinin tonë sepse rinija është e ardhëmja jonë dhe e kësaj shoqërije që po i mbush sivjet 30-te vite të themelimit!

***Mehmeti -*** Të ndëruar antarë të sh.k.a.Dardania nga Winterthuri të Zvicrës po mundohem tua përshkruaj jetën e 30 viteve me pak rreshta por ndoshta do të jetë e pa kuptimtë, kështu që kërkoj ndjes që do të jesin shumë e shumë gjëra pa u përmendur por të gjitha nga pak e ndosha arrijm të përmendim një 0,2- % të historisë sonë por sidoqoft për 3 - dekada kemë arrit të përcjallim shumë e shumë anëtar dhe tu mësojm të flasin shqip, e të vallzojnë shqip. Pra për veten time mezi që pres të vijn e premtja dhe te takoj artistët e shoqrisë sonë dhe gjerësa të mundm edhe pse në moshë do të jemë gjithënji pran, kësaj qendre kulturore. Përshendetje të pëzemërta për ju e nderuara SH.K.A Dardania!

***Valdet T. –*** Unë jamë pjesë e Dardanisë tash e 10 vite edhe ate në orkestër me instrumente frymore, dhe ne si shoqëri në Dardani kemi marrë përvojat më të mira në kontributin e folklorit dhe ruajtjen e traditës sonë kombëtare. Jamë njeriu më i privilegjuar dhe më me fat që jamë pjesë e SH.K.A "DARDANIA"!

***Labinoti -*** Jam shumë i impresionuar nga Shoqëria Artistike Kulturore - Dardania. Kam ardhur vazhdimisht për më shumë se gjysmë viti për të luajtur qifteli me bashkatdhetarët. Më pëlqen që është një grup shumë i ngrohtë në zemër dhe njëkohësisht shumë profesional. Pas disa kohësh, madje kam filluar të këndoj në grupin e orkestrës, si një talent që nuk e dija se e kisha. Marr pjesë në aktivitete të ndryshme të kësaj shoqërie dhe sa herë që orkestra i bie veglave dhe valltarët kërcejnë, trupi më rrëqethet nga ngazëllimi.

***Ekremi -*** Unë jam kyqyr në Dardania, pak më von, por këtu ndihem si më së miri dhe mundhohem të Papi kontributin timt këtu bashkë me shoqët dhe grupin e orkestrës por edhe me grupin e vajzave që kanë fillu me viju këndimin, më bënë edhe më obligues ta kultuvoj edhe më shumë traditën tonë sidomos në mërgatë!

# PËRSHTYPJET E DONATORËVE DHE SPONSORËVE TË SH.K.A „DARDANIA"!

**Nagipi -** Është me të vërtetë e veçantë kur bashkëpunimi midis komunitetit dhe ansambleve artistike sjellin fryte të tilla të bukura. Të qenit sponsor i SH.K.A "DARDANIA" për vitin 2024 jo vetëm që është një mbështetje për kulturën dhe traditën tonë, por edhe një investim në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar në diasporë. Duke ndarë këtë kënaqësi me SH.K.A "DARDANIA", ju po kontribuoni në përhapjen e artit dhe vlerave shqiptare. Bravo dhe uroj që ky bashkëpunim të sjellë shumë suksese dhe aktivitete të mrekullueshme në vitin që vjen! Më kënaqësi firma **OSTFINANZ, Nagip Memedi!**

***Ardiani -*** Dardania e ka përfaqësu kulturën tonë sidomos në mërgatë, e ka ruajtë traditën tonë si dhe në shumë festivale ka tregu profesionalitet duke u shpërbly me vend të parë e të dytë, po ashtu fëmijët tanë nuk i kanë harru traditat e zakonet tona falë shoqërisë kulturore dhe artistike Dardania! Ndjej kënaqësi që mund ta ndihmojmë këtë qendër kulturore. Me Respekt firma **ESP GROUP, Ardian Ilazi**!

***Qendrimi -*** Meqë unë isha vetë pjesë e kësaj shoqërije me vite të tëra, tani kur jamë përkushtuar bisnesit dhe punës sime profesionale, e pamë të rrugës dhe të nevojshme, që ta ndihmoj me plotë vullnet këtë shtëpi të madhe të kulturës me mundësit tona, andaj ndjehem krenat që isha vallëtar dhe tani edhe mbështetës financiar i Dardanisë! Me shumë suksese dhe urime 30 vjetorin e Dardanisë nga firma **SOTEC.CH, Qendrim Sopi!**

***Valdeti -*** Dardanin e mbështesim qe një vit dhe jemi të lumtur dhe krenar që sado pak mund të kontribojm në ruajtjen e kulturës dhe traditës shqiptare . Një shoqëri e tillë siq është Dardania, është një shpres për brezat e ri që ta vlersojn dhe ruajn kulturën tonë shqiptare, për ti mos mos i harrua traditat tona si p.sh këngët dhe vallëzimin. Ne si sponsorë, do vazhdojm në mbështetjen e Dardanisë dhe shpresojm që na bashkangjiten dhe shumë të tjerë, sepse e kemi të gjithë përgjegjësi ta ruajm kulturën tonë të bukur shqiptare! Me respekt të madhë dhe urime 30 vjetori nga firma **VM TEAM, Valtet Gashi!**

***Bekimi -*** Se pari dua të falenderoj Zotrin Shefqet Cakolli dhe bashkpuntorët e tij për punën e palodhur që bëjn për kulturen tonë. Personalisht kam vërejtur që këtu pjesmarrësit, si fëmijet e vegjël por edhe të rriturit mësojnë dhe kultivojnë traditën dhe kulturën tonë. SH. K.A "Dardania" është pjesë e kulturës dhe që ne e vlersojmë lartë, pos tjerash mësohet dhe flitet shqip dhe përfitimet janë shumë të larta për pjesmarrësit si dhe antarët.

Ka disa vite që ne mbështesim shoqërinë, por edhe në të ardhëmen do ta mbështesim. Është kënaqsi kur ne shofim që ka individ që kultivojnë dhe veprojnë duke sakrifikuar kohën dhe mundin për kulturen. Këtu në rrethin ku jetojmë, Dardania është shembullë si shoqëri dhe e vlersojmë lart punën e Dardanisë.

Me gjithë kënaqsi e ndihmojmë shoqërinë Dardania, sepse kultura është tradita e kombit tonë dhe janë shumë të çmuara dhe ndikojnë pozitivisht në zhvillimin tonë si kumunitet në Zvicër dhe rrethin. Edhe një here falemideroj z. Shefqet Cakolli për punën e palodhur ndër vite për zhvillimin dhe kultivimin e kulturës dhe traditës shqiptare në Zvicër. Ju urojmë 30 vjetorin nga stafi ynë i **BUDGET GROUP , dhe Bekim Prelvukaj!**

***Sherifi -*** Dardaninë dhe mua na kanë bashkuar rrugët e kulturës ka here, si fillim me ushtrime pasi që jam një vallëtar i vjetër, mirëpo në formë simbolike është hera e parë,që e ndihmoj! Patjetër që ndihem shumë mirë kur e ndihmoj kulturën, sepse jam rritur me kulturën shqipe, mua më ka formësuar shumë si person, dhe më ka mbajtur lidhur me çdo gjë shqip bile edhe me atdheun,andaj mendoj që është shumë e rëndësishme të ndihmojmë rininë tonë që të kenë një urë lidhëse me kulturën dhe gjuhën tonë! Dardania ishte dhe do të jetë një vatër e kulturës, që i bashkon të rinjët dhe gjithë grup-moshat pa dallim, me vallëzim, me këngë dhe mësime për instrumentet tona. Me vallëzimin shqip dhe kulturën jam rritur në mërgim, e dua çdo gjë shqipe dhe do të vazhdoj të kontriboj çdohere pse jo edhe përmes Dardanisë! Urime 30 vjetori i saj nga **BIASCA ENGINEERING, dhe Sherif Dakaj!**



# Rrugëtimi nëpër shekuj te vëllezërit Arbërshë!



Rrugëtimin te vëllëzërit Arbëreshë në Itali, e kishim ka here në mendje dhe secilën here që dikush e vizitonte ate, ne lakmonim dhe thonim; "*E sikur të ishim edhe ne atje* ", dhe kështu duke na ushqye dhe frymëzu për mbijetesën dhe ruajtjen e gjuhës, besimit, traditës, mënyrën e jetesës dhe zakoneve të vjetra gati 600 vjeqare, që nga koha e Skënderbeut e këtej, ardhur kryesisht nga viset tona shekullore të Shqipërisë së sotme dhe viset tjera, shtyrë nga mbijetesa, nga luftërat, nga shtypjet dhe rrethanat e pa favorëshme të popullit shqipëtarë duke i uzurpua tokat tona ndër shekuj, nga armiqët më të përbetuar që kishte historia e kombit tonë, duke fillua nga luferat me romakët, luftërat bizantine, pushtimi nga perandoria turke, grekët e deri te sllavët e jugut, por këtu ndalemi te periudha e famëshme e luftës së Gjergj Kastriotit-Skenderbeut, e më pas për çka sot po flasim.

Pikërisht duke shfletua kështu literaturat dhe shkrimet për Arbëreshët, po shpalosja dhe veqoja disa nga ato më të rëndësishmet, që sot ja vlenë ti përsërisim e që ishin shkruar nga shumë autor e shënime të grumbulluara nëpër gazeta e revista, por edhe përmes historive të tjera të shkruara me shekuj, por edhe tani më që kemi më shumë mundësi ti gjejmë shumë leht po deshëm ti hyjmë leximit, dhe të kaluarës sonë.

Arbëreshët e ardhur nga Shqipëria dhe viset tjera, në periudha e pushtimit otoman, dhe periudhës së lavdishme të Skenderbeut, e sidomos në pleqërin e tij dhe në veqanti pas vdekjes të tij, u vendosën kryesisht në jug të Italisë, duke u shpërndarë në komunitete si në; Abruzzo, Basilicata, Campagna, Calabria, Puglia, Molise, e Sicilia, ku identifikoheshin lehtësisht nga vendasit për shkak të gjuhës së tyre të veçantë që përdornin në të përditshmen e tyre. Edhe pse shumë nga këto komunitete shqiptare të ardhura në jug të Italisë, sidomos ata që u vendosën pranë zonave urbane të banuara nga vendasit, përgjatë dekadave e shekujve, nuk mundën t'i përballonin asimilimit, por edhe shpërnguljes nëpër pjesë të tjera të Italisë, si në Bari, Cosenza, Crotone, Milano, Napoli, Palermo, Torino, e gjetiu, bile gjatë shekullit të kaluar duke marr parasyshë edhe dyndjet dhe migrimet në Europë e Amerikë, që sot thuaja se janë të asimiluar shumica prej tyre.

Pikërisht për këtë flitet dhe thuhet se sipas disa studiuesve të ndryshëm, më shumë se 30 lokalitete arbëreshe janë asimiluar dhe e kanë humbur gjuhën dhe identitetin e origjinës duke u integruar së pari në atë italiane, më pas ato gjermane, amerikane e shtete tjera të Europës e Amerikës.

Sot, në të gjithë Italinë, e që njihen edhe zyrtarisht, janë përafërsisht më se 50 komunitete arbëreshe apo shqiptarë të Italisë, siç njihen ndryshe. Nga këto ndoshta mbi 40 komuna, 9 qendra të vogla, të shpërndara në 7 qarqe (regjione) të Italisë së jugut dhe ishujve në jug, rezultojnë që jetojnë si rezidentë rreth 200.000 shqiptarë të Italisë, gjithënjë sipas shënimeve të faktorit shqipëtarë, edhe pse përllogaritjet mund të jenë edhe më të mëdha marr për bazë mirgimet dhe asimilimet, edhe pse statistikat shtetrore të Italisë nuk i paraqesin më shumë se 100.000 banor me prejardhje arbëreshe.Qarqet (Regjionet) ku arbëreshët janë vendosur masivisht, madje në zona shumë pranë njëri-tjetrit, është Kalabria, me rreth 60.000 - 80.000 banorë, të vendosur në 30 komuna dhe 3 qendra më të vogla banimi, kryesisht në provincën e Kozencës. Një

komunitet i madh është vendosur në ishullin e Sicilisë, pranë Palermos. Në Puglia janë vendosur pak arbëreshë në 4 komuna, me rreth 12.000 – 14.000 banorë, të përqendruar kryesisht në Foggia, Casalvecchio e Chieuti, në provincën e Tarantos në San Marzano, por edhe Casalvecchio di Puglia – Kazallveqi, ishte vend takimi i festivalit " Vëllazëria" që organizohej në kuadër të komunës me kryetarin e saj të mrekullueshëm, Noe Andreano, i cili pranoi edhe librin monofrafik të SH.K.A "Dardania" në Winterthur të Zvicrës, dhuruar nga kryetari i saj. Ai rrinte dhe shoqërohej me të gjithë të pranishmit e këtij festivali, ku po merrnin pjesë këto grupe dhe shoqëri kulturore pa asnjë konkurenz, por thjesht pjesëmarrje dhe shoqërim vëllazëror ashtu ishte emërtu vetë emëri i festivalit "Vëllazëria".Ashtu sipas programit të paraparë, kryetari dhe panelistët kishin organizu një tryez, dhe hapjen e festivalit e bëri në bashkëpunim me organizatorët që i kishte gjithënjë afër, përkushtimishtë ishte edhe stafin teknik, që kujdeseshin për mbarëvajtjen e gjithë programit.



Në natën e parë u paraqiten vallëzime, këngë dhe lojra popullore e folklorike nga: *SH.K.A "Rapsha"* nga Tuzi në Malë të Zi, mandej *"Shpirti Arbërsh"* nga Cerzeto, *"Katundi ynë"* nga San Marzano, *"Pro Loco Arbëria"* nga Lungro, *"Qifti Arbëresh"* nga Chieuti, *"Tallandishat të Katundit"* ( nikoqire) nga Casalvecchio di Puglia etj.

*SH.K.A "Rapsha"* kishte ardhë nga Tuzi me autobusin e tyre për të shpalos vlerat e përbashkëta me vëllezërit arbëresh, me një program të pasur kulturor, të cilat u interpretuan me një përkushtrim dhe vullnet të madhë para masës së gjërë në këtë festival, duke përfëshirë këtu lojra popullore këngë dhe valle të kësaj treve. Por duke mos e anashkalua edhe diefilimin në dy netë rreshtë, e të gjitha grupeve pas inaugurimit të festivalit nga ana e kryetrit të komunës.





Grupi *"Shpirti Arbërsh"***,** që karakterizohej me këngët tipike arbëreshe, la të kuptoj se kënga në grup dhe vallja arbëreshe jeton dhe gjallëron edhe tek brezat e rinjë, por duke u mbështetur edhe nga më të vjetrit që ngjiteshin bashkë me ta në skenë, nënë përcjellje të një harmonike të tipike arbëreshe luajtun nga një i moshuar.
Grupi *"Katundi ynë"* ishte pak sa më shumë me një përzirje të gjenertave, duke përfëshir këtu edhe fëmij, të moshuar dhe të rinjë.
*"Pro Loco Arbëria"* nga Lungro, po ashtu kishte zgjedhur këngë edhe të kërcimeve, ku mund të vallëzonin edhe publiku dhe të kompletuar edhe nga veglat muzikore tipike të arbërshëve të kësaj ane.
*"Qifti Arbëresh"* nga Chieuti, po ashtu u prezentua me muzikë të vjetra arbëreshe të kombinuara edhe me vegla muzikore të cilat kompletoheshin me këngë solo të dy gjinive por edhe duet.





*"Tallandishat të Katundit"* si nikoqire nga Casalvecchio di Puglia,
(Kazallveqi) karakterizohej nga pjesëmarrja e të rinjëve, të dy gjinive dhe këngët e tyre arbëreshe të kënduara me pasion, por edhe vallëzime në dyshe sidomos gjatë defilimit në qytezën e festivalit.

Nuk mungoj as kënga nga Kosova, interpretuar nga orkestra e kombinuar aty për aty nga një dashamirë i kulturës dhe traditës sonë i cili jetonte dhe punonte në Itali, por që pasion e kishte qiftelinë dhe këngën shqipe.



***Kryetari i SH.K.A „DARDANIA" në mesin e vëllezërve Arbëreshë në Casalvecchio di Puglia!***

## Vizita në Katundin e Xhozef Diogardit së bashku me vëllezërit e trojeve tona, një shembullë për bashkim kombëtar

Katundin e Xhozef Diogardit dhe arbëreshët atje, kësaj radhe patëm rastin ti vizitojmë së bashku me gazetarin e mërgatës sonë Rexhep Rifatin që ishte hera e tretë e vizitës së vëllezërve arbëresh, kurse kësaj radhe dhe këtij qarku ishte hera e parë për te, si që ishte edhe për Gjergj Prenkoçaj, një veprimëtarë dhe pasionant i qështjes sonë kombëtare, dhe Shefqet Cakolli, kryetari i Shoqërisë Kulturore dhe Artistike në Winterthur të Zvicës, si grumbullues i folklorit burimor të trevave tona kombëtare, si dhe më pas në shoqërim të dy miqëve që u takuam në festivalin "Vëllazëria" në Kazallveqi, zonjën Elida Jorgoni, kryetare e Lëvizjes "Foleja Kombëtare Shqiptare" me seli në Durrës, dhe Luigj Junçaj nga Malësia e Tuzit, veprimëtarë në SH.K.A "Rapsha" ku vizituam Kadundin (Greci), aty ku lindën prindërit e Joseph DioGuardit, i cili lindi dhe jeton më tash në Amerikë.

E veqanta që binte në sy ishte Gjergj Kastrioti Skenderbeu, ku shumë sheshe dhe rrugë emërtoheshin në emër të tij, dhe tash kohëve të fundit ishin inauguru edhe buste dhe shtatore të Skenderbeut, duke marr për bazë 550 vjetorin e vdekjes së tij vitin që shkoj. Pështypje të veqanta patem sidomos me tabelat dhe njoftimet edhe në gjuhën shqipe, por edhe me bujarinë dhe mikëpritjen e arbëreshëve duke na përshëndet dhe ndrru ca fjalë edhe në gjuhën arbëreshe, me çka ne ju tregonim se ishim nga Shqipëria, Kosova dhe Malësia në Mal të Zi, ishim bërë kështu në rastësi tri vise të tokave tona, për ti vizitua vëllezërit tanë që po ruajnë me kaq fanatizën gjuhën traditën dhe kulturën e të parëve të tyre tash e 600 vjet.

Natyrishtë se kultura dhe besimi fetar dominonte thuaja se në të gjitha fshatrat dhe qytetet e arbëreshëve, andaj për hirë të saj vizituam edhe shtëpin dhe vendin e lindjes së shenjëtorit Padre Pio në qytetin e Pietrelcina, një qytez në maje të një kodrine me kështjellë dhe selin e vetë Shën Padre Pio, që respektohej nga të gjithë vitizorët për mrekullit e tija, për çka u bindem edhe ne me shtatoret e shumta që ishin vendos në ato anë dhe krahina të Italisë.



***Mbrëmja e dytë e festivalit jehoj më shumë me argëtim dhe muzik për relaksim.***

Në natën e dytë kishte kryesisht muzikë të kërcimeve për publikun dhe muzik të leht e melodi instrumentale orkestruar nga: *"Ethnos"* nga Lucera, e cila la një përshtypje se ky grup i kombinuar në këtë festival, prodhoj mrekulli me valle instrumentale dhe këngë të reja arbëreshe, me çka edhe fascionoj publikun me paraqitjen e tyre.
Po ashtu edhe këngëtarja e muzikës argëtuese Brunilda Lato nga Asquaformosa, që ishte bashkangjitur me ta, krijuan atmosfer të mrekullueshme me orkestrimin direkt të veglave dhe këngëve të tyre para publikut artdashës.



***Vizitat në qytezat dhe te vëllezërit arbëresh, na bënë të jemi krenar me bujarinë dhe afrinë që kishin për ne!***

**Chieuti – (Qefti),** një qytezë e populluar kryesisht me pasardhës të Skenderbeut, të cilët kishin edhe lagjen e Gjergj Kastrioti – Skenderbeut, si dhe të familjeve tjera të luftëtarëve të asaj kohe, i cili shtrihej në në naltësi të rrethuar nga ullinjë rrethë e për qark asaj naltësire, e që në një shesh të gjërë të saj ngrihej busti i Skenderbeut që kishte një prapavij të natyrës me ullinjë dhe flutura betoni që prodhonin rrymë.
Ashtu si kishim planifukua ti bënim një vizit disa fshatrave arbërshë, po përshkonim qytezen në këmbë duke marr pamje të arkitekturës dhe rrugicave të ngushta të lashtësisë së vjetër të qytetrimit, po rastësishnim në një miken tonë, që ishim takuanjë natë më parë në festivalin e Vëllazëria, e që sa po i kthteheshin nga plazhi i detit, sepse edhe ashtu bënte vapë e madhe atë ditë.
Pasi u përshëndetem me Arjana Ballukun, që vinte nga Tirana, ajo na njoftoj me burrin e saj arbërsh, që po jetonte në këtë qytet tash e 27 vite dhe kishin krijua familje me një vajz e cila po studionte mjekësin.
As që bëhej fjalë që ne ta refuzonim mikërpritjen e saj edhe në shtëpi, në frymën dhe zakonin tonë më tash të vulosur: *bukë, kryp e zemër*, për të parë edhe nga afër jetën dhe formën e jetesës së arbërshëve, ku ne patem fatin që të na shtjellonte shumë mirë jetën dhe veprimëtarinë e arbërshëve këtu dhe në rrethina tjera, për çka na la përshtypje gjuha e Donato D`Ascrnzo burrit të Arjanës i cili ishte adaptua me gjuhën e sotme shqipe dhe komunikonim me lehtësi, ashtu sikur të ishim në mes të Tiranës.
Më pas me propozimin e Arjanës, patem rastin të njifemi me studiusin dhe profesorin Mario Massaronit, i cili kishte vizitua disa here institutin albanologjik në Prishtinë eTiranë dhe kishte bërë një libër për qytetin e Qeftit dhe arbëreshët, me çka edhe ne morem nga një ekzemplar nga dora e tij, dhe që na lanë një mbres edhe këngët e zonjës Massaroni e cila këndoj disa këngë arbëreshe, dhe që shumë leht kuptoheshin fjalët e kësaj gruaje të mrekullueshme edhe pse e moshuar ajo ruajnt kujtime të mira nga të parët e saj.

Më pas vazhuam rrugëtimin tone drejt **Ururi – (Ruri),** i cili kishte një infrastruktur të rregulluar me emërtime dhe njoftime edhe në gjuhën shqipe - abëreshe, të rrugëve dhe institucioneve komunale, dhe patëm edhe disa takime me vendasit që flisnin me kënaqësi historit e tyre, por edhe përgjigjeshin pytjeve tona për numrin e banorëve dhe përkatësinë, duke na tregua se këtu janë të gjithë arbëreshë.

www.dardania95.ch







Pas Ururit vazhduam për në **Portocannone – (Porkanuni),** e cili qytezë ishte binjakzuar me qytetin historik të Krujës në Shqipëri, prej nga vizituam qendrën dhe bustin e Skenderbeut që ishte vendoj po ashtu këtë vitë, për të vazhdu edhe te shtëpija e pleqëve të cilët mundoheshin të na spjegonin prejardhjen edhe pse nuk mundnin të flisnin gjuhën edhe aq mirë në përjashtin të dy tre vetave.

Për të vijua kështu me qytezën e radhës shumë pran bregdetit Adriatik, **Campomarino – Këmarini**, ku flitej se Skënderbeu kishte fjetur disa here në takime të fshehura në kohën e luftës me otoman.

Veqanti e këtij qyteti ishin muralet që ishin stolisur me figura të Skenderbeut, Nënë Terezës, dhe papës së Vatikanit, por edhe punime tjera të përditëshmërisë së atëhereshme, si në vreshta, magje, peshkime e pamje tjera të mahnitëshme që e bënin qytezen shumë atraktive për vizitorët. Aty takuam edhe shqipëtarë nga Shqipëria të cilët ishin grumbullua në një klub gjuetije dhe po bënin llafe e po freskoheshin nga vapa e madhe që mbretroj ato dita.

Dhe krejt në fund ne po kthehehim nga misioni ynë duke lënë përshtypje tejet të mira për viziten që patem së bashku ne nga Zvicra me një betim se edhe në të ardhëmen do ti vizitojm viset tjera arbëreshe, për ti njohur më afër vëllezërit tanë, edhe ashtu pak të lënë anash nga shtetet tona instuticionale. Andaj edhe neve duhet të jemi edhe më të bashkur dhe më të devotshëm që ti ruajmë dhe kultivojmë këto vlera, që janë jetike për popullin tonë, e pse jo kur dihet se sot kanë ndryshua rrethanat, duke marr për bazë se sot ka mundësi të komunikojmë të bashkëpunojm, të shoqërohemi përmes kulturës së pari e pse jo edhe përmes poreve tjera të jetës dhe veprimëtarive ekonomike, arsimore, kulturore, sportive, krejt në në mirë të shqipëtarëve dhe pasardhësve tanë, ku do që janë ata.

Autor: Shefqet Cakolli

dardania94@hotmail.com




# SH.K.A "DARDANIA" NGA WINTERTHURI I ZVICRËS, MERR PJESË NË FESTIVALIN FOLKLORIK "HASI JEHON" 2024 NË GJONAJ

Me ftesën e SH.K.A "MALËSORI" dhe këshillit drejtues të këtij festivali dhe drejtorit artistik të festivalit z. Dilaver Kryeziut, tashmë edhe nën mbrojtjen të trashigimisë kulturore në kuadër të Ministrisë së Kulturës së Kosovës, e që tani ky festival po mbahet i 35-ti me radhë, ku do të performojnë shumë ansamble dhe shoqëri nga të gjitha trojet tona, e që do filloj nga 02 maji deri më 04 maj 2024, ndihemi të priviligjuar dhe kemi kënaqësi e obligim që të marrim udhë edhe përkundër shpenzimeve të mëdha, vetëm e vetëm për të promovua vlerat tona të ruajtura edhe në mërgatë.

***Paraqitja e SH.K.A "DARDANIA" mbahet më 04 maj 2024, në fushën e Pajtimit në Gjonaj, natën e fundit të këtij festivali tradicionale i 35-ti me radhë!***

Pregaditje kanë fillua me kohë, dhe grupi prej 35 vetave do të ngjitet në skenë në këtë festival madhështor dhe me traditë të lasht, prej nga do ti paraqesim vlerat tona me këngë, instrumentale e burimore, dhe rituale të traditave tona, të ruajtura me fanatizëm, duke e përfëshirë këtu edhe luftën e fundit dhe lirinë tonë në Kosovë!

Natyrishtë se gjatë kësaj kohe sa do të qëndrojmë në Kosovë, do të vizitohen edhe kompleksi memorian "Adem Jashari" në Prekaz, dhe varrezat e Reçakut në Reçak, për të vazhdua më pas në Prizerenin e bukur, dhe provat gjenerale që do të mbahen para se mu ngrit në skenë, të shtunën në mbrëmje ku edhe do ta hapin naten e fundit të këtij festivali me paraqitjen tonë nga mërgata jonë! Ju mirëpresim me kënaqësi: Këshilli Artistik i SH.K.A "DARDANIA"

Numri kontaktues: +41 79 672 41 82 dhe në Kosovë + 383 44 964 883




# Festohet edhe bashkë, «Drita» dhe «Dardania» festuan 12 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës



***Fund java që shkoj, edhe pse kaloj një javë nga dita e Pavarësisë 12-të të Republikës së Kosovës, në mërgatë kanë vazhdua manifestimet në shumë qyetete të Zvicrës e gjetiu, por jo vetëm kaq manifestime pati edhe në mbarë Europën aty ku jetojnë dhe veprojnë shqipëtarët.***

Kështu ishte edhe në Kreuzlingen të Zvicrës ku u festua dita e Pavarësisë së Kosovës, nënë organizimin e Ansamblit «Drita», nga Kreuzlingeni, dhe në bashkëveprim të programit edhe të SH.K.A «DARDANIA» nga Wintethuri e cila tash më ka kalua një qerek shekulli të veprimëtarisë së saj në rrafshin e kulturës në mërgatë përmes këngës, valles, dhe veshjeve tona tradicionale.

Që në fillim ishin kordinuar organizimet e dy qendrave kulturore për ta festua së bashku, 17 shkurtin, Pavarësinë e Kosovës, dhe tani po prisnin që të filloj edhe festa para shumë bashkëatdhetarëve që ishin tubua në sallën e madhe të qendrës sportive Dreispitz në Kreuzlingen të Kantonit Thurgaus në Zvicrër.

Me hapjen e kësaj feste që filloj me hymnin kombëtarë, më pas për të vazhdua me përshëndetjen nga moderatorja Valbona Shabani - Gashi, prej nga në emër të Ansamblit «Drita» dhe të SH.K.A «Dardania» i përshëndeti të pranishmit ku më pas ftoj edhe udhëheqësin e Misionit të Konsullatës së Kosovës në Cyrih, Sami Kastrati, i cili pasi potencoj me pak fjalë rëndësinë e kësaj date, e në veqanti potencoj rolin e mërgatës në përgjithësi, duke mos e harrua edhe shtetin e Zvicrës për mundësin dhe hapësirën që po ju jepë shoqatave dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive ky shtet që ndër të parat na njohu pavarësinë.

Më pas moderatorja ftoj në sken Shoqërinë Kulturore dhe Artistike «Dardania» me një *valle instrumentale* dhe një *këngë për pavarësinë*, orkestruar dhe kënduar nga orkestra me solistët: Sylë Sylaj, Hamit Shillova dhe Ekrem Beqiri, përcjellë nga orkestra e shoqërisë, për të vazhdua kështu me dy valle me të vegjëlit e Ansamblit «Drita», dhe më pas prap me dy këngë nga anëtaret e reja të Ansamblit «Drita», si dhe të këngëtares në mërgatë Xhemile Kryeziu, e cila u improvizua edhe në prapasken nga orkestra e pranishme.




Më pas në skenë u ngjitën vallëtarët dhe vallëtaret e SH.K.A «Dardania» për të prezentu pjesën më të përvuajtur të kombit tonë Çamërinë përmes valles, e cila u prit me vëmendje të veqant me *«Vallen çame»,* me gjithë kostumet e bukura që ishin përshtat asaj pjese, që shumë pak apo thuaja se fare nuk ishte parë para publikun nga një shoqëri që vepron në mërgatë tash e 25 vite.

Atmosfera e tillë vazhdoj edhe më tutje duke u relaksua edhe publiku me këngë dhe valle kushtuar kësaj feste që me ëndje e shijonte masa, sepse është një festë që ju është shtua populli tonë karshi festës së flamurit që po ashtu ka një veqanti të madhe si kombë.

Pas këngëve të interpretuara pasoj prap *«Vallja e zanave»* luajtur nga vajzat e Sh.K.A «Dardania» nga Winterthuri, të cilat prezentuan një stil të ri me muzik burimore, të pjesës së Matit, përshtat edhe veshjet dhe e veqanta e gjithë kësaj ishte po ashtu veshja dhe kompletimi i kostumeve tona popullore sidomos të shoqërisë Dardania, me çka pati edhe komplimente nga të pranishmit për diciplinën dhe sensin e shijen e veshjeve tona popullore nga të gjitha trojet tona.

Pasuan edhe dy valle nga Ansambli «Drita» të cilët prezentuan jo vetëm vallet e luajtura me pasion, por edhe kostumet e dizajnuara enkas për këtë festë, e që treguan një shembull se si ruhet tradita dhe kultura jonë kombëtare edhe në mërgatë.

Armosfera festive vazhdoj edhe për publikun, së pari me orkestrën e SH.K.A «Dardania» në kombinim me Ansamblin «Drita» me valle të lira me surle e tupana ku performuan të gjithë vallëtarët e dy grupeve, për të vazhdua edhe me publikun, me që kësaj radhe





Ansambli kishte ftua edhe këngëtarin e estradës sonë; Nikollë Nikprelaj, për ti argëtua masën e gjërë, prej nga publiku shijoj edhe vet vallëzimin nga këngët e nduarduarëshme të Nikollë Nikprelajt, për të mos mungua as sofra me ushqime tradicionale, si flija, djathra dhe speca turshi, rrethë e rrokullë edhe burra edhe gra, duke këndu së bashku.

Organizatori nuk kishte harrua as torten e madhe të 12 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës e cila më pas u shpërnda për të pranishmit.

Vlenë të theksohet se tërë programin dhe manifestimin përcjell edhe me nga një intervistë të shkurtër e përcolli edhe RTK-ja dhe gazetari Zenel Hajrizi i cili kishte ardhë enkas nga Kosova me ftesë të Ansamblit që më tash po hynë në vitin e 18-të të veprimëtarisë së saj. Po ashtu edhe gazetari i njohur i mërgatës sonë që përcjell thuaja se tërë aktivitetete e mërgatës i pa lodhurin dhe impresionanti i zhvillemeve të mërgatë Rexhep Rifati, prej nga edhe huazuan disa foto prej tij.

E gjithë ky organizim ishte inicuar në krye me kryetarin e ansamblit z. Hajredin Gashi, i cili po e mbanë këtë ansambël së bashku me stafin e tij dhe familjet që i ndohmojnë si familja; Kryeziu, Fejzullahu, Myrtaj, Ademi, Kastrati etj.

Fotot dhe tekstin:
Shefqet Cakolli

# Nga feste e popuvje në Winterthur të Zvicrën dhe fëmijët e dy kulturave!





*Një kujtim me bashkëmoshataret e grupit Tamil, si dhe shqiponja me duart e vogëla,*

# Epopeja e UÇK-ës, shënohet edhe nga mërgata në Zvicër

Prointegra07/03/2023




**Grupi i fëmijve të SH.K.A "Dardania" dhe kënga; "Mora fjalë"**

Përpos shënimit të kësaj date të rëndësishme për popullin tonë në Kosovë, që u kujtua në instancat më të larta të shtetit, si në parlament, në Prekazin legjendar, dhe me një akademi përkujtimore në Prishtinë, dhe vizitat te varrezat e Jasharëve, ashtu mbretëroj atmosfera edhe në Rapperswill-Jona të St. Gallenit, me një organizim që i kishte ftuar LVV-ja me tri pikat së bashku; Obersee, St. Gallenit dhe Winterthurit, duke fillua kështu me intonimin e himnit kombëtarë, pasi që kishin vërejtur se salla ishte e mbushur përplot, dhe nuk po i zinin më të pranishmit.



Pas intonimit të himnit, dy moderatorët e kësaj epopeje të lavdishme, zonja Shpresa Rrahmoni-Ida dhe Agim Sylejmanit, ata i përshëndeten të pranishmit, dhe ftuan kryesuesin e Këshillit Organizativ nga tri Pikat e LVV-ës, Obersee, St. Gallen dhe Winterthur, z. Ilmi Cakollin për një fjalë rasti, prej nga veçoj rëndësinë e kësaj date, dhe sakrificën e familjes Jashari dhe gjithë UÇK-ës, prej nga kuptuam se edhe vet kishte qenë pjesë e saj, në ditët e para prej nga sot po shpaloste fjalë vetëm për të rënët dhe ata që u flijuan për lirin tonë.

Menjëherë pas fjalës së kryetarit të pikës, moderatorët paraqiten programin artistik, i cili ishte përgatitur me kohë në këtë paraqitje enkas për momentin dhe vlerën që ka kjo datë për popullin tonë, prej nga për pjesën artistike organizatorët kishin të ftuar Shoqërinë Kulturore dhe Artistike "DARDANIA" nga Winterthuri, prej nga, si e do rendi ata u paraqiten së pari me korin e fëmijëve me këngën *"Mora fjalë"*, me çka u hap programi artistik për këtëshënim të epopesë së UÇK-ës dhe familjes Jashari, për të vazhdua më pas me një valle për fëmijë, po ashtu nga grupi i të vegjëlve të SH.K.A "Dardania", që vërtet publiku u nda tejet i

kënaqur dhe ju duartrokiti thuaja se gjatë gjithë kohës me paraqitjen e tyre në skenë në mosha kaq të vogla, por që ju morën zemrat publikut, me lëvizjet e tyre në skenë, dhe kulmi i gjithë kësaj ishte kënga *"Xhamadani vija vija"* për ta përfundua pjesën e tyre artistike edhe me recitimin e 4 vjeçarit Mael Kqiku, me vjershën e gjyshit të vet, *"Kush e nisi luftën i pari"*.




Më pas për ta bërë edhe më madhështore, këtë shënim të 25-të, të Epopesë së UÇK-ës, organizatorët kishin ftua edhe -ish z. komandantin e zonës operative së Karadakut, -ish zëdhënësin e FSK-ës, kolonelin e tani zv. Ministër i Mbrojtjes së Kosovës z. Shemsi Syla, i cili mes tjerash përshëndeti disa nga veprimtarët që ishin të pranishëm në sallë, dhe më pas shpalosi edhe peri petit që patën gjatë luftës, për kontributin e grave dhe burrave të lirisë, e në veçanti, heroizmit të familjes Jashari, prej nga shumë të rinjë dhe të reja u frymëzuan më pas për të kontribuar në lirin që e kemi sot. Ai nuk harroj të ju premtoj se ushtria e Kosovës do ta mbroj tokën e Kosovës pëllëmbë për pëllëmbë, dhe se sot kjo ushtri është një forcë që lirisht mund të mbështetemi te ta, sepse po forcohemi e po profesionalizohemi për ditë e më shumë, falë edhe bashkëpunimit me ndërkombëtarët që i kemi krahë.

Natyrisht se radhitja e programit ishte shumë e koordinuar, sa që me një here pas fjalës së zv. ministrit të mbrojtje, në skenë u ngjitën të rriturit e SH.K.A "Dardania" me vallen *"Për Hamëz Jasharin dhe UÇK-ës"*, që ngriti edhe emocione tek masa e të pranishmëve, me paraqitjen dhe koreografinë e tyre, posaçërisht atyre që e kishin përjetua luftës dhe që ishin kësaj here prezent, duke mos i




fshehur as lotët emocionues, që rrjedhin vet-vetiu, shpesh pa na pyetur fare, sepse ato tregojnë dhimbjen, sakrificën dhe njëherit edhe krenarinë, duke na bërë edhe të krenohemi se edhe këtu në mërgatë përmes fëmijëve që po lindin e rriten këtu  dhe po na sjellin plot emocione në shënimet e tilla tejet të dhimbshme dhe tejet të përgatitura mirë për opinionin dhe skenën, edhe për prindërit dhe gjyshërit që më tani veç se janë pensionuar disa nga ata. për Hamëz Jasharin dhe UÇK-ën, interpretuan  nga SH.K.A " Dardania" nga Winterthuri.

Andaj me mjeshtërinë e valltarëve përmes valles treguan shumë, së pari për familjen Jashari dhe gjithë UÇK-ën, në tërësi, sepse ata së bashku me bashkësinë ndërkombëtare sollën lirin që ne sot e gëzojmë, kurse ne sot ju thurim këngë e valle në shenj respekti për ta.

Epopeja e UÇK-ës, që po vijonte në një ambient të këndshëm dhe krenarie para të pranishmëve u paraqit edhe aktori ynë i madh Çun Lajqi, me monologun e tij, të preferuar për dëshmorët, për të rënët që nuk vdesin kurrë, për bashkimin e trojeve tona, për plisin dhe dheun e tokës sonë, prej nga u përcollën me ëndje, duke marrë disa here duartrokitje gjatë interpretimit të monologut të tij. Ai në fund porositi që të jemi bashkë dhe të mos përçahemi në ditët e sotme, sepse armiku ende është mbi supet tona.

Më pas në program ishin edhe dy pikat muzikore me flautë, ekzekutuar nga motrat Puhiza dhe Morea Shala, me interpretimin e dy pikave muzikore si: *"Moj e bukura more"* dhe *"Ty moj mollë e kuqe".*



Dhe krejt në fund rapsodi dhe folkloristi i njohur i diasporës Isuf Rashiti, këndoj një këngë kushtuar dëshmorit Mujdin Aliut, dhe marshin e UÇK-ës ose *"Jam Kosova e shqiptarisë"* prej edhe nga përfundoj kështu ky manifestin kulturor e përkujtimor me rastin e Epopesë së UÇK-ës, që u organizua në Rapperswill të Zvicrës, ndoshta e vetmja e këtij lloji në Zvicër, edhe pse pati edhe festa tjera, të shënimit të 15 vjetorit të pavarësisë së Kosovës, që organizoj Ambasada e Kosovës në Bern, dhe Konsullata në Zürich, por pati edhe të atilla që organizuan edhe 8 marsin, me këngë argëtuese e tallava.

Vlen po ashtu të theksohet se në hollin e sallës, pati edhe kënde librash të autorëve të ndryshëm si Çun Lajqi, Agim Sylejmani e Brahim Avdyli, por edhe revista e Albinfo dhe njoftime tjera të LVV-ës, si anëtarësimet dhe njoftime të ndryshme.

Me tu përfunduar i tërë ky shënim i Epopesë së UÇK-ës, me një here filluan aktivistët dhe këshilli organizativ ti zhvendosnin dekorimet e sallës dhe hollit, prej nga kishin pasur një punë goxha të madhe, por falë vullnetit dhe aktivistëve dhe kujdestarëve ajo u rrumbullakosua për çdo lëvdatë.

07.03.2023 Winterthur,
Autor i tekstit dhe fotove,
Shefqet Cakolli



# “Pantorama” e Amriswilit tuboi tri shoqëri artistike në Ditën e Pavarësisë

**Shoqata “Sharri” nga Waldkirch i St. Gallenit dhe SHKA “Dardania nga Winterthuri dhe Ansambli “Drita” nga Kreuzlingeni përmes një program të përzgjedhur, krijuan një ambient tejet të këndshëm festiv në përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës**

**Teksti dhe fotot Rexhep Rifati**



Data e 17 Shkurtit, me peshën e saj historike, bëri që në mbarë Zvicrën të vërshojnë me programe festive thuaja se të gjitha grupet dhe ansamblet artistike, ndaj edhe pune e ne kronistëve që përcjellim këto aktivitete nuk qe aspak punë e lehtë, ndaj edhe duke i përcjell nga disa manifestime brenda ditës po shkojmë edhe me raporte të vonuara. Ndaj edhe manifestimin në Amrsivill, në sallën reprezentative “Pantorama” duhet shikuar si hap të mirë, ngase festa e pavarësisë së Kosovës kishte tubuar tri nga shoqatat me një bagazh të mirë artistik, gjë që këtë e dëshmoi edhe programi i larmishëm, si dhe kostumet, që pos lojës krijonin edhe një kolorit për syrin e qindra pjesëmarrësve në sallë, së cilës megjithatë i mungoi publiku i mjaftueshëm. Ndërsa që moderimin e bëri Labinot Gashi, i njohur nga publiku me shkurtesën e popullarizuar Labi, që kishte ardhur nergut nga Prishtina.

Arsyeja mund të jetë edhe fakti se brenda një mbrëmje në regjionin e dy tri kantoneve të përafërta ishin 4-5 koncerte kushtuar Ditës së Pavarësisë.

I pari nga grupet që doli në skenë ishte Shoqata “Sharri”, me grupin e fëmijëve, duke sjell freski festive, ndërsa kryetari i kësaj shoqate, Nagip Memedi që ka dhënë një kontribut disavjeçar, me rritjen e numrin të anëtarëve dhe ngritjen e një godine kulture, paralajmëroi tërheqjen, por që falënderoj kryesinë dhe prindërit për mbështetjen që i kanë dhënë. Por edhe për te dhe të shoqen e tij pati falënderime nga ana e udhheqjes dhe prindërve të shoqatës “Sharri”.

Pasuan njëra pas tjetrës edhe prezantimi, “Dardanisë” së Winterthurit, meqë rast përshëndeti kryetari, Shefqet Cakolli dhe i “Dritës” si dhe i kryetari Haradin Gashi, të cilët pos që uruan festën edhe falënderuan nikoqirin për këtë bashkëpunim. Madje që të tre kryetarët, përmes një fotoje të përbashkët shprehën kënaqësinë që ky manifestim i bëri bashkë nën një kulëm këngëtarë e valltarë nga tri qendra ku me vite kulmojnë aktivitetet kulturore shqiptare.



# SH.K.A "DARDANIA" NGA WINTERTHURI I ZVICRËS, PËRVETËSOJ PUBLIKUN, NË FESTIVALIN FOLKLORIK "HASI JEHON" 2024

Ashtu si edhe ishte publikuar në media të ndryshme pjesëmarrja e SH.K.A "DARDANIA" në festivalin "Hasi Jehon" 2024, ashtu edhe ndodhi, që për tri netë rresht, kjo shoqëri të jetë prezente në këtë festival jashtëzakinisht autokton dhe në përmasa të mëdha, nata e tret ishte radhitja e SH.K.A "Dardania" edhe ate e fundit, apo si thuhet embëlsira për fund.

Vlenë të theksohet se në bazë të këshillit drejtues të



këtij festivali dhe drejtorit artistik të festivalit z. Dilaver Kryeziut, dhe drejtorit të SHKA "Malësori" z. Haziz Hodaj, tashmë edhe nën mbrojtjen e trashigimisë kulturore në kuadër të Ministrisë së Kulturës së Kosovës, ky festival u mbajt i 35-ti me radhë, ku u paraqiten mëse 24 ansamble dhe shoqëri kulturore nga të gjitha trojet tona, por e veqanta e gjithë kësaj ishte edhe pjesëmarrja nga mërgata e shoqërisë kulturore dhe artistike "Dardania" me seli në Winterthur të Zvicrës, e cila u prit si më së miri nga organizatori me sistemimin dhe mbarëvajtjen e festivalistëve, prej nga kjo pjesëmarrje e mërgatës u përcoll edhe nga mediat elektronike dhe të shkruara me një theks të veqant të prezentimit të tyre me një rini thuja se krejt të lindur dhe rritur në mërgatë.

Programi i përzgjedhur nga udhëheqësi artistik, z. Shefqet Cakolli, dhe ndihëmuar nga korreografët e rregulltë të kësaj qendre kulturore, kishte një veqanti tejet emocionuese për publikun, marrë për bazë sidomos ritualin e qujatur "Dasma e Pavarësisë" ku ishte përfëshirë edhe pjesa më sublime e lirisë sonë



UÇK-ja, kuptohet me lidhëmërin edhe të paraluftës, represionit, luftës dhe në fund të dasmës së lirisë sonë tradicionale me doke dhe tradita të shqipëtarëve, sidomos pas lirisë që na sollen luftëtarët tanë.

Natyrisht se nuk munguan edhe veglat e veqanta si kavalli, mishnica dhe okarina, ekzekutuar nga veterani i kësaj qendre kulturore, z. Hamit Shillova, prej nga u nda i kënaqur pas angazhimit të ngarkuar të rolit të tij, edhe me valle instrumentale dhe këngën kushtuar festivalit, së bashku me Ekrem Beqirit, dhe orkestrën e saj, ai dha edhe një intervistë televizionit lokal, për ndjeshmërin e këtij festivali, ku ne më 2012 kishin zërë vendin e parë dhe çmimin e veshjeve më të dalluara.

Gjatë gjithë kësaj kohe publiku ishte nën përcjellëje me duartrokitje dhe emocione të përziera të një prezentimi dinjitoz të mërgatës, pavarësisht të kriteteve të jurisë për disa arësye, që nuk janë



domethënëse, publiku i dha çmimin më meritor paraqitjes së SH.K.A “DARDANIA”nga Winterthuri, karshi jurisë që i kishte kriteren e veta.

Po ashtu edhe kryetari i kësaj qendre kulturore, faleminderoj organizatorët e festivalit dhe ishte i kënaqur me realizimin dhe synimit të tij lidhur me prezentimin e pjesës së tyre para publikut të mrekullueshëm, edhe përkundër shumë sakrificave, shpenzimeve të mëdha të rugëtimit, prej nga shpalosi edhe ambicjet se ne nuk kemi ardhur për çmime, por kemi ardhur për pjesëmarrëje, por gjithësesi na kanë nderu publiku me duartrokitjet e tyre të pa ndërprera gjatë paraqitjes sonë, dhe ju jemi mirënjohët, e jemi të nderuar nga ai publik.





Vlenë të theksohet se gjatë qëndrimit në Kosovë, kjo shoqëri vizitoj edhe kompleksin memorial të familjes Jashari në Prekaz, prej nga u frymëzuan edhe një here si gjithënjë, përkundër faktit se kjo, nuk ishte hera e parë që kjo shoqëri e viziton këtë vend të shejt të kombit tonë.

Po ashtu pas përfundimit të natës së fundit të festivalit, të nesërmen, ajo mori rrugën për në Komoran, për gjirime të emisionit tash më të njohur “Rrënjët Tona” dhe drejtorit të saj Burim Krasniqi, në studion moderne Redmedia, e cila po shpalos folklorin tonë burimor, edhe përmes vallëve të RTK-ës, e cila ka një shukueshmëri publike, dhe mjaftë të gjërë.



Të gjithë festivalistët pjesëmarrës, e që në total ishin 35 veta në sken, kuptohet edhe një numër i vogël i bashkëpunëtorëve, dhe anëtarëve tanë të jashtëm edhe në Kosovë, prej nga kryetari në emër të shoqërisë i faleminderon të gjithë për kontributin e tyre, përfëshirë këtu edhe sponsorën që na mundësuan shpenzimet kaq të mëdha që u

krijuan më rastin e pjesëmarrjes së gjithë këtyre pjesëmarrësve të këtij festivali mirë të organizuar. Ata sot janë krenar për pjesëmarrjen në këtë festival dhe menjëhere i presin detyrat tjera, sepse kjo shoqëri sivjet feston edhe 30 vjetorin e saj të themelimit, i cili do të organizohet më 30 nëntor në Winterthur të Zvicrës.
08.05.2024, Winterthur. Autor i tekstit dhe fotove,  Shefqet Cakolli







SHOQËRIA KULTURORE DHE ARTISTIKE
DARDANIA
Në hap të traditës kombëtare!
FORMULARI
Emri: Mbiemri:
Datëlindja:
Emri i prindërit:
Adresa:
Numri Postal:
Shtetësia: Vendlindja:
Telefoni: E-maili:
Grup-mosha: Të rriturit:
Numri i veshjeve: Këpucave:
Nënshkrimi: i Prindërit:
Data: Vendi:
Adresa e uahtrimeve: Kronaustrasse 21, 8400 Winterthur


SH.K.A - A.K.V „DARDANIA“
Oststrasse 33
8400 WINTERTHUR
Nat: +41 79 672 41 82

Të nderuar bashkëkombasë,
Të nderuara veprimëtari ekonomike,
Të nderuar prindër,
Të nderuar dashamirë të kulturës!

Shoqëria Kulturore – Artistike „DARDANIA“ nga  Winterthuri, është duke kontribua tash e 30 vite, në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar, përmes gjuhës, këngës, valles, e veshjeve tona tradicionale të kombit tonë. Mbështetja juaj së pari na nderon duke na ndihmua në qëllimin tonë të përbashkët! Ju duke kontribua në Shoqërinë Kulturore - Artistike „Dardania“, nga veprimëtarit tuaja, ne bashkë do ti ruajmë fëmijët tanë nga asimilimi dhe do ta ruajmë identitetit tonë, këtu në mërgatë. Ndihma apo kontribut juaji, do të ndikoj në vazhdimin dhe ruajtjen e traditave tona shekullore, ku fëmijëve tanë do t`ju mbjellim vlerat kombëtare, për ti përcjellë te brezat që po rriten e lindin këtu. Ju që jeni prindër, mund ti sjellëni fëmijët tuaj edhe në vallëzime e këndime pranë nesh, për ti ruajtur vlerat tona kombëtare bashkë me gjuhën tonë më të bukurë në botë, gjuhën shqipe!
Anëtarësia për një vit, për një fëmijë është 250 Fr.-, për ata që kyqen aktiv në valle apo këngë e vegla muzikore, kurse për anëtarë pasiv është prej 50 Fr.-, për një personë!
Kurse për donacione dhe sponzorime, e keni tabelen në faqen tonë të internetit!
Pra duke ju faleminderua paraprakisht për gadishmërin tuaj në kontribute dhe anëtarësim në SH.K.A „DARDANIA“ duke ju plasua edhe QR - kodin e ri dhe formës së pagesës!

***Ju faleminderit, dhe gjithë të mirat në veprimëtarin tuaj ekonomike e familjare!***
*Me respekt: Kryesia dhe stafi Administrativ,*
*SH.K.A „DARDANIA“ Web-Faqja: www.dardania95.ch* Kontakti *dhe adresa elektronike:*
*Nat: 079 672 41 82 dardania94@hotmail.com , info@dardania95.ch*

Empfangsschein
Konto / Zahlbar an
CH50 3013 2016 8028 0360 6
Albanischer Kulturverein Dardania
Oststrasse 33
8400 Winterthur
Referenz
00 00001 68028 03606 00000 01100
Zahlbar durch (Name/Adresse)
Währung Betrag
CHF
Annahmestelle

Zahlteil
Währung Betrag
CHF

Konto / Zahlbar an
CH50 3013 2016 8028 0360 6
Albanischer Kulturverein Dardania
Oststrasse 33
8400 Winterthur
Referenz
00 00001 68028 03606 00000 01100
Zahlbar durch (Name/Adresse)

# FAQJA JONË ZYRTARE E INTERNETIT:

# www.dardania95.ch

info@dardania95.ch ose dardania94@hotmail.com




**https://www.facebook.com/**




**https://x.com/SHKADARDANIA**



**https://www.instagram.com/sh.k.a.dardania/**




**https://www.youtube.com/@QYLKIJA**




**https://soundcloud.com/dardania**

Adresa administrative e Shoqërisë Kulturore - Artistike DARDANIA" është:

SH.K.A "DARDANIA" Oststrasse 33, 8400 Winterthur, Mob: +41 79 672 41 82
Shefqet Cakolli - Kryetar dhe udhëheqës Artistikë
Nat: 079 672 41 82 ose info@dardania95.ch
Hamit Shillova - Udhëheqës i orkestrës
Albulena Kqiku, koreografe - pedagoge,
Muhamet Kqiku, koreograf - solist;
Arbnore Cakolli, asistente - koreografe te të rriturit,
Dhurata Cakolli, asistente te grupi i fëmijëve,
Besiana Mazrekaj, asistente dhe koreografe,

Orari i ushtrimeve, të premteve:

Prej orës 19:00 - 20:30 grupi i të vegjëlve
Prej orës 20: 45 - 22:45 grupi i të riturëve
Prej orës 20:00 - 22:00, grupi i orkestrës
Prei orës 10:00 - 12:00 rezerva ( të shtuneve)

Adresa e ushtrimeve:

MOJAWI - Kuba21, Kronaustrasse 21, 8404 Winterthur

XHIROLLOGARIA:

**MIGROSBANK, 8401 WINTERTHUR**
**ALBANISCHER KULTURVEREIN "DARDANIA" DES KANTONS ZÜRICH**
**IBAN NR: CH26 0840 1016 8028 0360 6**

# Pasthënje mbi monografinë e SH.K.A „DARDANIA“ nga kompozitori e kritiku i muzikës sonë burimore dhënë nga prof. Sami Piraj



**Rreth monografisë së Shoqërisë Kulturore-Artistike "Dardania" nga Wintenturi**

**Semantika e këngëve, valleve, riteve, me gjuhën autentike skenike**

Çështjet diskursive mbi artin dhe kulturën, gjithnjë kanë qenë dhe mbetën probleme të jetës sonë kulturore. Natyrisht se edhe muzika nuk shqitet jashtë këtyre kornizave problematike. Është shkruar mjaft mbi fenomenin e tëhuajsimit të vlerave autoktone të muzikës por edhe të çështjeve të tjera. Por ky problem ende mbetet aktual.

Ndonëse kultura në Kosovë ende vuan nga pasojat e de institucionalizimit të jetës, artit dhe kulturës, faktor këto që determinuan tkurrjen në jetën artistike, mbetet edhe sot enigmë, se si të krijohet rregull në këto parametra të artit. Janë këtu gjithsesi edhe problemet e mungesës se mjeteve materiale, shkapërderdhja e kudrave relevante si dhe mosharmonizimi i strukturave të institucioneve që veprojnë sot te ne.

Megjithatë, edhe në këto mungesa të natyrës objektive e subjektive, është krijuar një klimë që sinjifikon aspektin përmbajtsor të jetës artistike. Fjalën e kemi për Ansamblet e profileve të ndryshme të artit muzikorë, pastaj Shoqëritë Kulturo- Artistike, festivalet por edhe personat dashamirë të artit të cilët me sakrificën e tyre, bëjnë shumë për rrjedhën e vlerave muzikore. Institucionet që veprojnë, sot ballafaqohen me mungesën e një kuadri që i përgjigjet nevojave dhe kërkesave aktuale të jetës kulturore e artistike. Si rrjedhojë e kësaj mangësie, ende e kemi të pranishme problemin e quajtur shund dhe kiç i cili vazhdon të lulëzojë, madje në një farë mënyrë e në shumë raste e ka margjinalizuar artin e vërtetë, duke u bërë sinonim i keq i rrethanave kulturore.

Valorizimi i vlerave duhet të jetë alfa dhe omega e institucioneve tona, e ansambleve dhe njerzëve që punojnë për të hapur rrugën krijimeve origjinale të bazuara në frymën autentike pse jo edhe të harmonizuara më gjuhën universale. Avancimi i mëtejmë dhe ballafaqimi me probleme janë sfida të cilat vështirë por ngadalë po tejkalohen, duke shpresuar gjithnjë në ngritjen e kuadrove në lëmi të ndryshme të kulturës por edhe të institucione relevante të tyre.

Janë trajtuar këto fenomene te ne, duke pasur një bindje se të dëmshmet e artit mund të margjinalizohen. Mjerisht këto parregullsi, apo fenomene të ashtuquajtur të "ballkanizimit antikulturor" kanë vazhduar dhe vazhdojnë të mbeten "thembër e Akilit". Posaqërisht kjo reflektohet dendur në muzikën tonë shqiptare duke krijuar vakum të papërmirësueshme për një kohë të caktuar.

Shtrohet pyetja pse jemi të "detyruar" t' i pasqyrojë këto "fenomene" në një monografi të akcilës solemne siç është ky Libër që botohet në përvjetorin e 20-të të Ansamblit "Dardania" nga Vintenturni nga Zvicra?!.

***Janë shumë fakte që na shtyjnë të merremi me këtë çështje*.**

Së pari, Ansamblet e tipit "Dardania" nga Vintenturni dhe të ngjashme si kjo që veprojnë në trevat shqiptare, intrigojnë me origjinalitet në formë dhe në përmbajtje. Veshja origjinale, që sipas shkrimeve në këtë botim janë porositur dhe punuar në vendin ku zë fill logjika e traditës, tregon për një përkujdesje rigoroze drejt asaj që e themi më lartë me konotacione negative. Pra udhëheqësit e Ansamblit nuk i shqiten formulës që në këtë aspekt të rëndësishëm të logjikës vizuale, mos të merren me imitim. Sepse imitimi nuk është kategori e vlerës. Përkundrazi, imitimi në art e kulturë, sidomos në muzikë, manifestohen shpesh me jo kreativitet dhe pa ndjeshmëri që muzika e ka si barometër të vlerës. Pra gërshetimi i kostumeve me muzikën tradicionale, që personifikon projektin e ruajtjes së trashëgimisë shpirtërore në një ambient goxha larg nga atdheu, konsideroj se është logjikë e fort e ruajtjes së truallit, fuqisë që të mbahet fort për trungun dhe rrënjën. Këtë e kam parë edhe në paraqitjet e këtij ansambli në Festivale kombëtare në Kosovë, sidomos, në Festivalin mbarëkombëtar në Gjonaj ku ansambli "Dardania" është nderuar me çmimin e parë si shoqëria më e mirë e festivalit.

Lirizmi i unifikuar në ritmin e melosit të këngëve e valleve të truallit, nuk është maksima definitive skenike e Ansamblit "Dardania" nga Vintenturni. Epika është trasuar shumë mirë në kërcime, në lojë, në përmbajtje. Ajo qëndron në ndjeshmërinë e prezantimit vokal të solistëve. Ajo qëndron në hapa të valltarëve, në ngjyrën e kuqe dhe të bardhë duke




dhënë shembull për një kombinim të idesë dhe mesazhit për t'i qëndruar besnik brezave.

Orkestra e "Dardanisë" nga Vintenturni që shoqëron këngët, vallet, ritet apo që luajnë meloditë e tyre, mban nj peshë të madhe në realizimin me sukses të cilësisë së konkurrimeve. Kështu sharkitë dhe çiftelitë e madhësive të ndryshme, të përshtatura për regjistrat e zërave të djemve e të vajzave, vënë në duar ekzekutuesish deri virtuoz, e kryejnë më së miri këtë detyrë. Melloditë të organizuara në formë suitash, ku shpesh del në pah elementi solistik, janë krijime që e përsonifikojnë ansamblin. Pa u futur në detaje të eksplorimit muzikor, mund të themi se arma kryesore e këtij ansambli është:

**-Dashamirësia ndaj traditës, kulturës muzikore**
**-Forma e narracionit muzikor deri në detaje**
**-Sakrifica e të gjithë anëtarëve për një sukses dhe**
**-Harmonia për të arritur jetësimin e idealeve në skenë dhe jetë.**

Mbase fjala ideal duket jo e denjë për të dhënë një argument muzikor për ansamblin, kur ajo ka konotacion të një profili tjetër, mbase edhe politik e patriotik.

Por shikuar nga një perspektivë e largësisë së Ansamblit me truallin, matur me mijëra kilometra e jo me perspektivën e qëndrimit fizik shumë pranë rrënjës, trungut dhe traditës, konsideroj se fjala ideal mbetet e qëndrueshme dhe e brumosur në mendjen dhe frymën e të gjithë anëtarëve të Ansamblit.

Kur themi këtë, bazohemi në punën e tyre jo vetëm në muzikë, por edhe të asaj se: **"Dardania" nuk kishte vetëm qëllimin e kulturës, këngës dhe valles, pasi ajo gjithnjë shqyrtoi edhe tema tjera si shkollën, gjuhën, historinë tonë, mandej humanizmin, komunikimin dhe njohjen familjeve e të rinjve mes veti**. Citat i nxjerr nga Monografia.

A nuk flet kjo më shumë se një sakrificë. Madje konsideroj se është thjesht një mision që duhet përshendetur. Gjatë leximit të monografisë e ndjejë dendur këtë fjalë. Pra mision. Sepse pikërisht nga aspekti humanitar duke e apostrofuar këtë me projektet humanitare me moton**: Duke shijuar kënaqësinë tuaj shpirtërore, ju ndihmoni një familje skamnore"** që ishte dhe do të mbetet, njëri nga projekte më kulminante dhe domethënëse për gjithë anëtarët, donatorët, dhe kontribuesit e këtij aksioni i cili kurorëzohet me ndërtimin e shtëpive me të gjitha pajisjet e nevojshme për jetë të familjeve skamnore në Kosovë. Ja pra fjala mision merr kuptim, merr ngjyrë dhe merr domethënje pa ekuivoke. Pa zhurmë, pa rrahje gjoksi siç na ndodhë shpesh të shikojmë e dëgjojmë për akte të tilla. Pra kjo iniciativë dhe bamirësi nuk do koment.

Në fund duke lexuar opinionet shumë të ngrohta, të sinqerta të ndjeshme për punën dhe vlerat e Ansamblit që edhe unë iu bashkangjitem me shumë dashamirësi, seç më ra në sy një mendim i thënë *nga koreografja Albulena Cakolli:*

*"Jeta ime ishte dhe mbetet"Dardani"*

Kam shumë fjalë dhe kujtime me "Dardaninë". Shton ajo.

Ne jemi 6 anëtar në familjen e ngushte. Prindërit e mi, motra, vëllai dhe unë. Anëtari i gjashtë i familjes ishte gjithmonë "Dardania". Çdo rast familjar, çdo aktivitet, çdo pjesë të jetës time, Dardanin e kam pasur si hijen time, e cila më përcillte në çdo hap. Shumë herë e kam pyetur veten: "Si do ishte jeta ime pa Dardaninë" përfundon citati.

Duke përfunduar këtë shkrim modest për Ansamblin "Dardania", nuk mundem pa e theksuar edhe një çështje thelbësore të jetës dhe të punës të komunitetit tonë në Zvicër dhe përgjithësisht në diasporë. E kjo është imazhi ynë dhe ballafaqimi ynë me logjikën e integrimit në Evropë.

Konsideroj se puna profesionale dhe kreacionet e paraqitjeve para publikut zviceran të **"Dardanisë" kanë pasur një rol pozitiv në thyerjen e imazhit jo gjithherë të mirë për shqiptarët.** Kjo vërehet në koncerte në shfaqje publike në sjellje, në kulturë të komunikimit, në frymëzime artistike në ruajtje të trashëgimisë, në eksplorime individuale e grupore të riteve, zakoneve e që mbetet ende një pasaportë sado e vogël hyrëse për Evropë. Përgëzojmë për këtë kontribut, përgëzojmë për të gjitha ato që Ansambli "Dardania" i realizojë me ndjeshmëri për të hapur rrugën vlerave gjithherë drejt asaj që konsiderohet e shenjtë në muzikë.

Dhe zoti na dha muzikën që të lutemi pa fjalë për te.

Prof. Sami PIRAJ

# 2025

30 Vite

## SHOQËRIA KULTURORE DHE ARTISTIKE DARDANIA

### January

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 |
| 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | |

### February

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 1 |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 |

### March

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 |
| 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | 31 | | | | |

### April

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 |
| 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | | |

### May

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 1 | 2 |
| 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 |
| 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
| 31 | | | | | | |

## 25 VJETORI I SH.K.A „DARDANIA“



## 30 VJETORI DO FESTOHET KËTË VIT!

### June

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |
| 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 |
| 28 | 29 | 30 | | | | |

### July

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 |
| 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 |
| 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | |

### August

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | 1 |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 |
| 30 | 31 | | | | | |

### September

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | | | |

### October

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 1 | 2 | 3 |
| 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 |
| 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 |

### November

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
| 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 |
| 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 |
| 29 | 30 | | | | | |

### December

| Sun | Mon | Tue | Wed | Thu | Fri | Sat |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | 31 | | |



SH.K.A „DARDANIA“
079 672 41 82

www.dardania95.ch
info@dardania95.ch

Oststrasse 33
8400 Winterthur


SH.K.A DARDANIA FESTON 30 VJETORIN !
DHE 28 NËNTORIN DITËN E FLAMURIT KOMBËTAR
SHOQËRIA KULTURORE - ARTISTIKE DARDANIA
NË BASHKËPUNIM ME DONATORËT, SPONSORËT DHE ANËTARËT E SAJ, SHËNON 30 VJETORIN E THEMELIMIT!
30
Vite
NË HAP TË TRADITËS KOMBËTARE
AUF DEN SPUREN DER TRADITION
30 NËNTOR 2024
AULA, KANTONSSCHULE RYCHENBERG
RYCHENBERGSTRASSE 110, 8400 WINTERTHUR
HYRJA VETËM ME FTESA!
Sponsorët e artit e kulturës sonë, përmes SH.K.A „DARDANIA"
HYRJA VETËM ME FTESA!
Info: SH.K.A „DARDANIA", Oststrasse 33, 8400 Winterthur, Nat: +41 79 672 41 82 www.dardania95.ch, info@dardani95.ch,

# Sponsorët e SH.K.A „DARDANIA" në gazetën periodika me rastin e 30 vjetorit të saj!

sotec.
sotec.ch

VM Team
Präzision ist unser Handwerk

ESP GROUP
ROHRREINIGUNG
KANALREINIGUNG
KANAL-TV
24H NOTFALL-SERVICE
ROHRSANIERUNG
KANALSANIERUNG
SCHACHTSANIERUNG
PLANUNGS-SERVICE
ENTKALKUNGS-SERVICE

budget credit
KREDITE bis 350 000 CHF
Laufzeit 6 bis 120 Monate
Persönliche Beratung unter
Gratisnummer 0800 555 500 oder Mobil 076 505 20 00
Standort: Untertor 8, 8400 Winterthur
Jetzt scannen und beantragen: Ihr Kreditantrag in 2 Minuten.
Jetzt online unter www.budgetcredit.ch

KMU Trex
Ihr Treuhandexperte

S-T ISOLATIONEN
Rychenbergstrasse 55 a
8400 Winterthur
Nat: 079 432 25 30
Fax: 052 222 99 07
e-mail: stahiri15@hotmail.com
anitär und Heizungs Isolationen

OST FINANZ
Nagip Memedi
Geschäftsführer
Mobile: 079 202 06 06
n.m@ostfinanz.ch
www.ostfinanz.ch
OstFinanz GmbH
Rorschacherstrasse 234
9016 St. Gallen
Tel.: 071 226 50 00
Fax: 071 226 50 01

DakaPaint GmbH
Daka Idriz
076 236 4001
dakapaint@hotmail.com
Bahnweg 29
8806 Bach SZ

MINERGIE
BIASCA ENGINEERING
gut durchdacht
perfekt gemacht
Biasca Engineering AG ■ 8957 Spreitenbach ■ www.biascaengineering.ch

BeFi
Facility Services AG

Respekt për sponsorët tanë, dhe mundësi e hapësirë edhe për të tjetët si këtu, andaj investoni në traditën tonë e mos ngurroni, sepse ne jemi ata që to ti ruajmë fëmijët tuaj nga asimilimi!

2b STUDIO